


URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.125 PRILL 2018





REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR
Syrja Xhelaj

REDAKTORË
Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT
Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË
Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku

DESIGN
Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË
SHTYPESHKRONJËN**

"Urtësia
Bektashiane"

Prill, 2018

Përgjegjësi më të mëdha mbi veten

Përgjegjësi më të mëdha mbi veten

Parlamenti Libanez dhe Asambleja Interparlamentare për Ortodoksinë, në bashkëpunim me Bashkimin Ndërparlamentar Arab, organizuan në mjediset e Parlamentit, në Bejrut të Libanit...

Lidhje e Mëdha, detyrë e mëdha

...ndërkohë atëherë, Lidhja e Mëdha... Lidhja e Mëdha... Lidhja e Mëdha...

Parlamenti Libanez dhe Asambleja Interparlamentare për Ortodoksinë, në bashkëpunim me Bashkimin Ndërparlamentar Arab, organizuan në mjediset e Parlamentit, në Bejrut ...



VEPRA E IMAM ALIUT a.s MIDIS TRADITËS DHE MODERNITETIT



Simposiumi Ndërkombëtar në Tiranë

Ditën e shtunë, datë 27 mars 2016, në Hotelin "Tirana" të Tiranës, Selia e Shenjtë Bektashiane, organizoi në mjediset e "Hotel Tirana - Internacional", Simposiumin Ndërkombëtar me temë: **Vepra e Imam Aliut a. s midis traditës dhe modernitetit**.

Simposiumi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë. Në këtë rast, simposiumi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Simposiumi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Etyd nga 22 marsi



Etydi nga 22 marsi

Në ditën e shtunë, datë 22 mars 2016, në Hotelin "Tirana" të Tiranës, Selia e Shenjtë Bektashiane, organizoi në mjediset e "Hotel Tirana - Internacional", Etydin nga 22 marsi me temë: **Etydi nga 22 marsi**.

Etydi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Etydi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Nderim për dede Reshat Bardhin

Buzi i tij vendoset në qendër të sqyteti të Ballshit



Nderim për dede Reshat Bardhin

Në ditën e shtunë, datë 22 mars 2016, në Hotelin "Tirana" të Tiranës, Selia e Shenjtë Bektashiane, organizoi në mjediset e "Hotel Tirana - Internacional", Nderimin për dede Reshat Bardhin me temë: **Nderim për dede Reshat Bardhin**.

Nderimi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Nderimi u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Faltes vetëm dashuri

Në 95 vjetorin e kalimit nga jeta të dereshit Ilias Kulmanut



Faltes vetëm dashuri

Në ditën e shtunë, datë 22 mars 2016, në Hotelin "Tirana" të Tiranës, Selia e Shenjtë Bektashiane, organizoi në mjediset e "Hotel Tirana - Internacional", Faltes vetëm dashuri me temë: **Faltes vetëm dashuri**.

Faltes u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Faltes u hap me një mesazh të vlerësimit të veprës së Imam Aliut, si një veje të shprehur të shpirtërisht dhe intelektualisht të lartë.

Vepra e Imam Aliut a.s midis traditës dhe modernitetit

Ditën e martë, datë 20 mars 2018, Selia e Shenjtë Bektashiane, organizoi në mjediset e "Hotel Tirana - Internacional", Simposiumin Ndërkombëtar me temë: Vepra e Imam Aliut a. s midis traditës dhe modernitetit.

Etyd nga 22 marsi

Nuk kanë marrë asnjë ftesë të veçantë Naskush. Por kanë pasur sigurisht brenda vetes, ftesën (jo në formën e saj klasike prej letre) se duhej bërë diçka për ditëlindjen e Imam Aliut, paqja qoftë mbi të. Janë drejtuar për në Selinë e Shenjtë Bektashiane në Tiranë, duke dëshmuar vullnetin e paepur se kjo ditë e madhe vlenë të jetohej ndryshe.

Nderim për dede Reshat Bardhin

Si rrallë herë, në 4 marsin e këtij viti, Sqyteti i Ballshit dhe gjithë Mallakastra, kanë përjetuar një ditë të veçantë festive që lidhet me dy eventimente të rëndësishme, pelegrinazhin vjetor tradicional në teqenë bektashiane të Greshicës...

Faltes vetëm dashuri

Dervish Iljasi në fizionominë fizike Trup mesatar, i imtë, sytë e vegjël, i shkëlqenin, sy të ndritshëm si vetëtim, të kaltër e ndriçues plot gjallëri, por edhe gjallëri shpirtërore, të brendshme. Tek ai, në pamjen e parë të binte në sy fytyra e thatë, e hequr, me mjekër dhe trup mesatar, thatanik.

VEPRA E IMAM ALI TRADITËS DHE MO



Simpozium Ndërkombëtar në Tiranë

Ditën e martë, datë 20 mars 2018, Selia e Shenjtë Bektashiane, organizoi në mjediset e “Hotel Tirana – Internacional”, Simpoziumin Ndërkombëtar me temë: Vepra e Imam Aliut a. s midis traditës dhe modernitetit. Përveç klerikëve dhe besimtarëve bektashianë nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi, morën pjesë: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij Ilir Meta, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë Haxhi Skënder Bruçaj, Kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, zj. Loreta

Aliko, Ambasadori i OSBE-së në Tiranë z. Bernard Borchard si dhe koordinatori bektashian për Francën dhe Belgjikën z. Aziz Vardari. Njëherazi të pranishëm në sallë ishin studiuesit e ardhur enkas për këtë event nga Gjermania, Azerbajxhani, Kosova, Rusia, Turqia, Iraku, Bosnja, Maqedonia dhe Shqipëria. Simpoziumi u ndoq nga media vendase dhe të huaja, të cilat pasqyruan idetë dhe sfidat me të cilat po përballet bektashizmi.

Vepimtarisë i parapriu shfaqja e një dokumentari mbi pelegrinazhin

në malin e Tomorrit, realizuar nga një bashkëpunim franko-belg. Më tej, si gjithmonë u këndua himni për flamurit, për t’ia lënë vendin përshëndetjes së Kryegjyshit Botëror Bektashian. Ky tha midis të tjerave: “ Simpoziumi i sotëm ndërkombëtar më jep mundësinë t’ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe më lejoni që në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, t’ju uroj gjithë të mirat ju dhe familjeve tuaja. Allahu i Lartë, Haxhi Bektash Veliu dhe dymbëdhjetë imamët i paçim kurdoherë

UT a.s MIDIS DERNITETIT


thelli tragjedinë dhe stoicizmin që do të shoqëronin jetën e tij. Ai e shenjtëroi imamin tonë me frymën e tij, i dha forcë e guxim duke dashur ta përgatisë për fatin që e priste. Janë me mijëra tregimet, mbresat, fjalët që na kanë ardhur deri në ditët e sotme për këta dy shtylla të Islamit, por unë do t'u kujtoj vetëm një sentencë madhështore. Dikur, Profeti ynë i tha imamit: "O Ali, Allahu të ka zbukuruar



dritë, në udhëtimin tonë shpirtëror! Një veprimtari ndërkombëtare si kjo e sotmja, është një dritare e çelur më shumë, në diturinë dhe qëndrimet bektashiane. Një derë, e cila duke e çelur dalëngadalë na çon në ndijime parajsore, në ato thënie të urta dhe të mrekullueshme në të cilat Imam Aliu, aleqym selam, udhëhoqi mijërat e besimtarëve edhe në betejat më të vështira. Dhe kur nënvizoj togfjalëshin "betejat më të vështira", nuk parashoh aspak ato me deve dhe shpata, por betejat e mëdha me nefsin njerëzor, me hipokrizinë, me padijen,

me etjen për para dhe pushtet, me moralin jo të pastër të shoqërisë së asaj kohe. Imami ynë jo vetëm që diti të udhëheqë plot urtësi dhe durim, besimtarët në këto luftëra të gjata me vite, por me jetën dhe veprën e tij, zbuloi të vërtetën e madhe se një jetë e tillë ja vlen të jetohet edhe nëse koha fizike e saj shkon nëpër dallgë humbjesh dhe fitoresh. Pa dashur të bëj histori (sepse jam i bindur se studiuesit e sotëm do thonë fjalën e tyre) besoj se ne ndajmë të gjithë, idenë se Profeti Muhamed që në çastin e lindjes të nipit ndjeu së


me virtytin më të bukur. Ai të ka dhuruar dashurinë e krejt njerëzve të pafuqishëm". Ja pra, ky ishte dhe mbeti misioni i madh i Imam Aliut, t'ju shërbej pikërisht njerëzve të pafuqishëm të kësaj bote. Historia e Islamit dhe veçmas ajo e imamatit dëshmoi se askush si Ima Aliu, nuk mund të mbante në supë një peshë kaq të rëndë në kontekstin e urtësisë dhe devocionit ndaj Krijuesit. Padyshim, jeta e imamit tonë ishte një shembull jo vetëm për ndjekësit e Islamit, por edhe të tjerë, që konceptet njerëzore nuk i masin aspak me egon e tyre, por



në diçka shumë më të shenjtë që mund t'i shërbejë së ardhmes. Por lapidare do të mbeten edhe fjalët e tij të fundit, ndaj vrasësit të pabesë. Ja kush ishte porosia e fundit dhënë familjarëve të vet: “Nëse jetoj, çështja e vrasësit është në dorën time. Nëse vdes, puna e tij mbetet në dorën tuaj. Nëse vazhdoni të zbatoni ligjin, atëherë mjafton vetëm në goditje. Por nëse e falni, dijeni se falja është më afër devotshmërisë”. Unë kam bindjen e plotë se fjala e studiuesve të sotëm, do të na bëjë më të vetëdijshëm, jo vetëm për trashëgiminë tonë identitare dhe fetare, por edhe për të sotmen, sepse në fund të fundit, vështrimi i Imam Aliut, i ka kapërcyer shekujt dhe vjen sot tek ne, si një ogur i bardhë për ta ndjekur me vëmendjen e madhe dhe devocionin e thellë.”

Ndërsa Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Haxhi Skënder Bruçaj, në përshëndetjen e tij u ndal sidomos në vlerat e evokimit të figurave të tilla, siç është Imam Aliu, të cilat u shërbejnë brezave të sotëm, sidomos në pikëpamjen

Një veprimtari ndërkombëtare si kjo e sotmja, është një dritare e çelur më shumë, në diturinë dhe qëndrimet bektashiane. Një derë, e cila duke e çelur dalëngadalë na çon në ndijime parajsore, në ato thënie të urta dhe të mrekullueshme në të cilat Imam Aliu, aleqym selam, udhëhoqi mijërat e besimtarëve edhe në betejat më të vështira. Dhe kur nënvizoj togfjalëshin “betejat më të vështira”, nuk parashoh aspak ato me deve dhe shpata, por betejat e mëdha me nefsin njerëzor, me hipokrizinë, me padijen, me etjen për para dhe pushtet, me moralin jo të pastër të shoqërisë së asaj kohe. Imami ynë jo vetëm që diti të udhëheqë plot urtësi dhe durim, besimtarët në këto luftëra të gjata me vite, por me jetën dhe veprën e tij, zbuloi të vërtetën e madhe se një jetë e tillë ja vlen të jetoj edhe nëse koha fizike e saj shkon nëpër dallgë humbesh dhe fitoresh. Pa dashur të bëj histori (sepse jam i bindur se studiuesit e sotëm do thonë fjalën e tyre) besoj se ne ndajmë të gjithë, idenë se Profeti Muhamed që në çastin e lindjes të nipit ndjeu së thelli tragjedinë dhe stoicizmin që do të shoqëronin jetën e tij. Ai e shenjtëroi imamin tonë me frymën e tij; i dha forcë e guxim duke dashur ta përgatisë për fatin që e priste. Janë me mijëra tregimet, mbresat, fjalët që na kanë ardhur deri në ditët e sotme për këta dy shtylla të Islamit, por unë do t'u kujtoj vetëm një sentencë madhështore. Dikur, Profeti ynë i tha imamit: “O Ali, Allahu të ka zbuluar me virtytin më të bukur. Ai të ka dhuruar dashurinë e krejt njerëzve të pafuqishëm”.



shpirtërore dhe morale. Ndër të tjera, ai pohoi:”.... Më lejoni ta filloj fjalën time të shkurtër më një citim nga Dede Reshat Bardhi (Zoti e mëshiroftë!), i cili shprehej kështu: “Udha bektashiane si një pjesë e pandarë e Islamit, e ushqyer nga burimi i Ehli Bejtit (familjes së Profetit Muhamed a.s.) si një frymëzim mistik, qe ka për qëllim lartësimin e shpirtave, pastrimin e zemrave dhe edukimin e unit, egos së njeriut, që me frytet e veta ushqeun zemrat e etura të besimtarëve, ka ndikuar në vendosjen dhe fuqizimin e marrëdhënieve të mira mes anëtarëve të shoqërisë dhe bashkësisë së këtyre trevave me përkatësi të ndryshme fetare”. Mirëkuptimi dhe toleranca ndërmjet qytetërimeve e përjetuar në Ballkan gjatë një periudhe disa shekullore është rezultati më i bukur i bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare dhe një rol të rëndësishëm në konsolidimin e kësaj bashkëjetese ka padyshim edhe komuniteti bektashian. Rrugëtimi



shpirtëror i bektashinjve, i brumosur dhe i frymëzuar nga mësimet islame, dhe tradita e Ehli-Bejtit arriti të bëhej një urë komunikimi dhe bashkëpunimi, e cila la gjurmë të thella në Ballkan dhe në popullsinë e trevave shqiptare në veçanti... Pothuajse të gjithë idealistët frymëzohen nga heronjtë e tyre

Ndër të tjera, ai pohoi:”.... Më lejoni ta filloj fjalën time të shkurtër më një citim nga Dede Reshat Bardhi (Zoti e mëshiroftë!), i cili shprehej kështu: “Udha bektashiane si një pjesë e pandarë e Islamit, e ushqyer nga burimi i Ehli Bejtit (familjes së Profetit Muhamed a.s.) si një frymëzim mistik, qe ka për qëllim lartësimin e shpirtave, pastrimin e zemrave dhe edukimin e unit, egos së njeriut, që me frytet e veta ushqeun zemrat e etura të besimtarëve, ka ndikuar në vendosjen dhe fuqizimin e marrëdhënieve të mira mes anëtarëve të shoqërisë dhe bashkësisë së këtyre trevave me përkatësi të ndryshme fetare”. Mirëkuptimi dhe toleranca ndërmjet qytetërimeve e përjetuar në Ballkan gjatë një periudhe disa shekullore është rezultati më i bukur i bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare dhe një rol të rëndësishëm në konsolidimin e kësaj bashkëjetese ka padyshim edhe komuniteti bektashian.

Rrugëtimi shpirtëror i bektashinjve, i brumosur dhe i frymëzuar nga mësimet islame, dhe tradita e Ehli-Bejtit arriti të bëhej një urë komunikimi dhe bashkëpunimi, e cila la gjurmë të thella në Ballkan dhe në popullsinë e trevave shqiptare në veçanti...



Nga fjala e Presidentit të Republikës Shkëlqesia e Tij Ilir Meta



Në këtë udhëtim shekullor, në mënyrë të veçantë do të vlerësoja kontributin, sakrificat dhe mundin e shumë bektashinjve të ndritur me në krye Dede Reshat Bardhin të cilët ringritën nga hiri Kryegjyshatën tonë Bektashiane. Figura të tilla nuk i përkasin vetëm bektashizmit shqiptar, por dhe atij botëror, duke na bërë krenarë. Për bektashinjtë tanë Shqipëria ngelet mbi gjithçka! Për lirinë, shkollën dhe kulturën kombëtare ata nuk kanë kursyer as jetën, pasi Atdheu është për ta edhe gjuhë, edhe identitet, edhe besim, edhe fe. Besimi bektashian u përfaqëua prej shqiptarëve për vetë mesazhin dhe mistikën hyjnore që përfaqësonte. Ky besim u shndërrua gjatë shekujve në një burim jo vetëm dialogu e tolerance, por edhe në një faktor të rëndësishëm kulture, patriotizmi, edukate dhe filozofie optimiste. Duhet theksuar se kjo fe dhe erë e re besimi gjeti gjithashtu tek shqiptarët një komb mendjehapur, me tradita të shëndosha të burrërisë, nderit dhe krenarisë.

Mbresa të veçanta tek të pranishmit la ndërkaq fjala e Presidentit të Republikës, Shkëlqesia e Tij, Ilir Meta. “Ai pohoi: “Jam i lumtur që jemi bashkë në këto momente feste të Sulltan Novruzit! E prita me kënaqësi të veçantë ftesën tuaj për të marr pjesë në simpoziumin me temë: “Imam Aliu midis traditës dhe modernitetit”. Në këto ditë gjithë vëmendja, përkushtimi dhe dashamirësia shkojnë për ju dhe besimtarët Tuaj, pasi besimi që përfaqësoni dhuron përherë shpresë mirëkuptim, paqe dhe harmoni! Vlerësoj lart idenë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për të trajtuar në simpoziume të përvitshme tema dhe ide rreth doktrinës bektashiane, rolit të udhëheqësve të saj të ndritur dhe raportit të fesë dhe shoqërisë shqiptare.

Tema të cilën keni përzgjedhur këtë vit është mjaft domethënëse. Kontributi dhe personaliteti i Imam Aliut vazhdon të inspirojë dhe të ngelet i qenësishëm edhe pse kanë kaluar rreth 15 shekuj nga aktiviteti i Tij. Në thelb të veprës së vet Imam Aliu predikoi dhe lartësoi dijen dhe drejtësinë, sepse vlerat e vërteta njerëzore, paqja shpirtërore dhe progresi shoqërisë e kanë burimin te dituria dhe te drejtësia. Bektashizmi përfaqëson një besim tradicional, dije dhe kulturë të konsoliduar në Shqipëri. Shumë personalitete të shquara, shqiptarë dhe të huaj,

kanë shkruar studime për bektashizmin dhe bektashianët, për besimin dhe cilësitë, për vlerat dhe kontributet që ata i dhanë kulturës sonë. Do të doja të përmendja-Naim e Sami Frashërin, Gjysh Ali Gjirokastrën, Abdyl Frashërin, Mid'hat Frashërin, Evlia Çelebiun, Natali Klerë, Hafëz Ali Korçën, Syrja Vlorën, Edvin Zhak, Faik Konicën, Musine Kokalarin e shumë personalitete të shquara. Në këtë udhëtim shekullor, në mënyrë të veçantë do të vlerësoja kontributin, sakrificat dhe mundin e shumë bektashinjve të ndritur me në krye Dede Reshat Bardhin të cilët ringritën nga hiri Kryegjyshatën tonë Bektashiane. Figura të tilla nuk i përkasin vetëm bektashizmit shqiptar, por dhe atij botëror, duke na bërë krenarë.

Për bektashinjtë tanë Shqipëria ngelet mbi gjithçka! Për lirinë, shkollën dhe kulturën kombëtare ata nuk kanë kursyer as jetën, pasi Atdheu është për ta edhe gjuhë, edhe identitet, edhe besim, edhe fe. Besimi bektashian u përfaqëua prej shqiptarëve për vetë mesazhin dhe mistikën hyjnore që përfaqësonte.



Ky besim u shndërrua gjatë shekujve në një burim jo vetëm dialogu e tolerance, por edhe në një faktor të rëndësishëm kulture, patriotizmi, edukate dhe filozofie optimiste. Duhet theksuar se kjo fe dhe erë e re besimi gjeti gjithashtu tek shqiptarët një komb mendjehapur, me tradita të shëndosha të burrërisë, nderit dhe krenarisë.


Harmonia midis feve në Shqipëri është tashmë proverbiale. Ndaj ne krenohemi me të.

Firmëtarët tanë të Pavarësisë dhe themeluesit e shtetit shqiptar u kujdesën me largpamësi që shteti i shqiptarëve të ngrihej mbi të gjitha besimet dhe në radhë të parë mbi unitetin kombëtar.

Në të gjitha debatet për emancipimin e vendit, bektashinjtë të prirë nga baballarët e tyre mendjendritur, kanë mbështetur reformimin e shtetit dhe përparimin e shoqërisë. Në këtë tendencë bashkëkohore, ata gjithashtu kanë qenë dhe janë të predispozuar vazhdimisht edhe për përsosjen, rinovimin dhe modernizimin e besimit të tyre. Ky fakt është jo vetëm krenari, por merr akoma dhe më shumë vlerë sot kur në botë dhe jo larg nesh fryjnë erëra të rrezikshme ekstremizmi dhe radikalizmi. Prandaj duke qenë i bindur në këtë filozofi kaq optimiste që ju frymëzoni, dua njëkohësisht edhe t'ju uroj suksese në këtë simpozium që e vlerësoj si një kontribut mjaft të rëndësishëm jo vetëm për bektashizmin, por në mënyrë të veçantë për të konsoliduar dhe forcuar harmoninë dhe bashkëjetesën tonë ndër-fetare.”



dhe formësojnë identitetet e veta duke u përpjekur ndjekin rrugën, veprat dhe sjelljet e këtyre heronjve. Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, personifikon një njeri model për të gjithë heronjtë vetësakrifikues të shumëpëritur nga bota e së nesërme. Kjo për faktin se ai u rrit e u edukua nga vetë dora e udhërrëfyesit më të madh të njerëzimit, profetit Muhamed (alejhi selam). Ai u mor nga Profeti Muhamed që kur ishte fëmijë dhe u rrit nën mbikëqyrjen e tij afër sôfrës hyjnore. Prej Profetit a.s. mësoi nderin, fisnikërinë, besën dhe virtytet më të larta njerëzore. Ky bashkim e mbrojti gjithashtu edhe nga papastërtitë e injorancës dhe e përgatiti si njeri e lider për një jetë të pastër e dinjitoze. Imam Aliu është simbol i rezistimit kundër të keqes dhe të ligës, dhe simbol i trimërisë në përpjekjen për shërbim të sinqertë ndaj Zotit. Ai nuk ishte vetëm një simbol i guximit dhe trimërisë, por gjithashtu një personalitet udhëheqës në thellësitë e botëve metafizike dhe shpirtërore. Të njohësh personalitetin, veprat, bindjet e Hazreti Aliut (a.s.), do të thotë të njohësh nga afër një mysliman të vërtetë, njeriun e një morali të lartë, njeriun model që bota e sotme moderne, e trazuar dhe me shumë dhimbje, ka nevojë ta ndjeke sot më shumë se kurrë si shembull i përkryer për të gjithë njerëzimin. Si një udhëheqës dhe drejtues shteti ai besonte se: Nëse në një shoqëri, të dobëtit nuk mund të dalin para të fuqishmëve dhe pa kurrfarë frike të mund të kërkojnë të drejtat e tyre, shoqëria e tillë nuk mund të anojë në shenjtëri dhe pastërti, dhe nuk mund të shpëtojë nga papastërtitë, turpi dhe të këqijat”. Së fundmi më lejoni t'ju uroj suksese këtij simpoziumi ‘Vepra e Imam Aliut a.r midis traditës dhe modernes’ dhe të gjithë panelistëve dhe studiuesve që do marrin pjesë në këtë simpozium dhe ta mbyll fjalën time me një fjalë të urtë të Imam Aliut: “Këto janë katër cilësitë që janë më të vështirat për t'u arritur: të falësh



kur je i nevrikosur, të tregosh bujari edhe në kohët kur je ngushtë, ta ruash nderin edhe teksa je vetëm për vetëm me mëkatin dhe t'ia thuash të vërtetën ashtu siç është edhe njeriut të cilit i frikësohesh apo je i lidhur në interesa me të”. Brenda këtyre rreshtave mund të gjejmë edhe shërimin e shumë sëmundjeve shpirtërore që përjeton njeriu i sotëm i kohëve moderne.

Kryetarja e Komitetit Shtetëror të Kulteve znj. Loreta Konomi u ndal në vlerat që Komuniteti Bektashian Shqiptar ka manifestuar prej kohësh. Ajo shtoi: Duke ju falenderuar për ftesën, shpreh kënaqësinë për të marrë pjesë në këtë Simpozium, krahas të ftuarve vendas e të huaj, si përfaqësuese e Komitetit Shtetëror për Kultet i cili mbështet fuqimisht aktivitete të tilla.

Shqipëria, ky vend i vogël, që është shndërruar në qendër botërore të këtij komuniteti me zemër të madhe, mbledh sot përfaqësues të nderuar që të përkujtojnë një figurë të shquar të islamit, Imam Aliun, si një nga 12 Imamët, figurat pilastër të fesë islame. Imam Aliu me urtësinë dhe dashurinë për drejtësi, mbetet një nga modelet më të mira të tolerancës dhe paqes për besimtarët dhe njerëzimin. Kjo figurë, me bujarinë dhe përlësinë e një njeriu me vlera të larta, i dedikoi jetën e tij të varfërve, duke u bërë

shembull për brezat e ardhshëm.

Një nga shprehjet e tij ishte :” Thjeshtësia është një nga degët e përhapura nga madhështia e vërtetë”. Është pikërisht ky virtyt i thjeshtësisë që karakterizon veprën e klerit bektashian



dhe që transmetohet dhe perceptohet nga besimtarët. Brumosur me këto mësim, vëllezërit bektashianë, kanë përcjellë dhe përcjellin mesazhe humanizmi, dashamirësie dhe paqeje tek besimtarët, dhe për këtë, shteti shqiptar ju është mirënjohës. Fryma e tolerimit, e dashurisë dhe e nderimit për të gjithë burrat dhe gratë, pavarësisht racës, fesë apo kombësisë, dhe po kështu ndjenja e brendshme fetare, ndihma për njerëzit në nevojë, mirësjellja, ndershmëria, fryma e solidaritetit, barazisë, vëllazërisë, lirisë dhe demokracisë e të tjera si këto, janë të gjitha mesazhe që bektashinjtë përpiqen të përçojnë vazhdimisht, si të vetmet tipare thelbësore të ideologjisë së tyre, por njëkohësisht si pjesë e pandarë e ideologjisë tradicionale shqiptare të bashkëjetesës. Bektashinjtë, sëbashku me besimtarë të feve të tjera, të drejtuar nga leader kombëdashës, i kanë dhënë Shqipërisë njerëz atdhetarë. Sot ata, krahas vëllezërve të besimeve të tjera, japin kontributin në ruajtjen dhe forcimin e harmonisë ndërfaqetare, kësaj vlere të vyer që na kanë lënë të parët tanë.

Dialogu, respekti, dëshira për të ndërtuar dhe bashkëpunuar me fetë e tjera,

janë dhe duhet të jenë karakteristikat e besimeve në Shqipëri.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për rolin dhe rëndësinë e fesë në momentet që kalojmë, si një mjet për ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare e rajonale. Sot, kur skemat ndërkombëtare të politikave shtetërore ndryshojnë me një dinamizëm intensiv, kur flukset migratore për shkak të luftrave dhe varfërisë janë shtuar, nevoja e integritit të të huajve, e njohjes së tyre nga afër, dhe, bashkë me të, e potencialit kulturor – fetar që mbartin, është vitale për shmangien e konflikteve. Prandaj, mësimet e Imam Aliut mbi përlulesinë ndaj tjetrit, nënkuptuar si nevojë dhe hapje drejt njohjes së emigrantit, besimtarit të një feje tjetër, bëhen më aktuale se kurrë.

Naimi i madh, poeti ynë bektashian shkruante: “Kërkonja gjetkë t’a gjeje Zotn’ e math e të vërtetë,/ Ay qënëkej ndaj meje, /E paskësja unë vetë!

Nisur nga këto fjalë të mençura, le ta njohim e pranojmë njëri – tjetrin, le të mundohemi të gjejmë gjuhën e përbashkët e pikat ku mendimet tona konvergjojnë, për t’i dhënë të rinjve shembuj pozitivë e për të kontribuar në ngritjen e një shoqërie të shëndoshë! Shteti shqiptar ka qenë dhe është i gatshëm të mbështesë çdo iniciativë në këtë drejtim.

Duke përfaqësuar sot Komitetin Shtetëror për Kultet, si institucionin e vetëm që bashkërendon marrëdhëniet midis Shtetit dhe fesë, unë do të doja sërisht t’ju përcjell mesazhin që angazhimi ynë do të vazhdojë të jetë i gjithanshëm, që këto marrëdhënie të jenë sa më të konsoliduara, në të mirë të paqes, respektit dhe sinqeritetit.


Ndërsa ambasadori i OSBE në Tiranë z.Borchard në përsëritjen e tij falënderoi Kryegjyshin Botëror për ftesën dhe njëherazi dha konsiderata të larta për Selinë e Shenjtë Bektashiane dhe rolin e saj thelbësor në promovimin e harmonisë fetare në Shqipëri. Në fund ai theksoi rëndësinë e madhe e veprimtarive të tilla të cilat e ruajnë dhe e pasurojnë më tej traditën fetare të çdo komuniteti

duke dhënë një shembull të dukshëm në kontekstet kohorë që kalojmë. Identitetet kulturore janë një pasuri e cila të ndihmon në rrugëtimin drejt familjes natyrale evropiane.

Koordinatori i kulturës bektashi-



ane për Francën dhe Brukselin, z. Aziz Vardari, në përsëritjen e tij u ndal sidomos në jehonën e tarikatit bektashi në kulturën perëndimore. Kjo jehonë, sipas tij, ka bërë të mundur që sidomos në Paris e Bruksel, të pasionuarit pas eventeve të traditës



kulturore, të kuptojnë se gurma e Islamit është gjithmonë e pashtershme. Bektashizmi, e mbylli ai fjalën e vet, përmes imazhit që përcjellë në botë, sa vjen dhe bëhet më atraktiv edhe për jo myslimanët.



Panelin e kumtesave e çeli Dr. Ali Gozi nga Gjermania, i cili u ndal më së shumti në shfaqjet e personalitetit gjenial të Imam Aliut.




Zëri i tij i butë dhe i ëmbël thërriste: "Arabi nuk ka përparësi ndaj jo arabit veçse me devotshmëri dhe njeriu është vëlla për njeriun, e do ose e urren". Thirrja për vllazërim njerëzor, ishte barazia e njerëzve në të drejtat e tyre. Në këtë zë bënte pjesë edhe thirrja për çlirimin e gruas nga dhuna e burrit, çlirimi i skllavit, punëtorit nga poshtërimi i punëdhënësit, ishte zëri i një revolucioni për shoqërinë. Krahas të dërguarit të Zotit e pas tij këtë zë e shoqëroi dhe e drejtoi Ali Bin Ebu Talib për të cilin Shibli Shumaj thotë: "Imam Ali bin Ebu Talibi, i madhi i të mëdhenjve, hapja e vetme. Si kjo figurë nuk kishte parë as Lindja as Perëndimi, nuk ishte parë as në kohët e hershme e as do të shihet më vonë.

Ai mëtoi fakte të sjella përmes dokumenteve të kohës, ku edhe në çastet më të vështirë, imami ynë dëshmoi vullnetin e palëkundur në Zot. Midis të tjerave, Dr. Gozi tha: "Imam Aliu në misionin e tij kishte program pune të drejtat e njeriut. I dërguari i Allahut, paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të, rriti krenarinë e popullit arab. Zëri i tij i butë dhe i ëmbël thërriste: "Arabi nuk ka përparësi ndaj jo arabit veçse me devotshmëri dhe njeriu është vëlla për njeriun, e do ose e urren". Thirrja për vllazërim njerëzor, ishte barazia e njerëzve në të drejtat e tyre. Në këtë zë bënte pjesë edhe thirrja për çlirimin e gruas nga dhuna e burrit, çlirimi i skllavit, punëtorit nga poshtërimi i punëdhënësit, ishte zëri i një revolucioni për shoqërinë. Krahas të dërguarit të Zotit e pas tij këtë zë e shoqëroi dhe e drejtoi Ali Bin Ebu Talib për të cilin Shibli Shumaj thotë: "Imam Ali bin Ebu Talibi, i madhi i të mëdhenjve, hapja e vetme. Si kjo figurë nuk kishte parë as Lindja as Perëndimi, nuk ishte parë as në kohët e hershme e as do të shihet më vonë. Figurë plotësisht origjinale". Kjo figurë qëndroi në krye të historisë për shekuj me radhë deri në ditët e sotme. Ai solli mendime të reja mbi jetën dhe vdekjen, ligje te reja në legjislacione, në sistemet,

në kushtetutat, në ligjet morale për bashkësinë njerëzore, bashkëpunimin e njeriut me njeriun në një shoqëri, për të gjithë me të drejta të barabarta. Ato ishin vlera që la trashëgim për të parët e pastaj ata i trashëgojnë tek pasardhësit. Ali bin Ebu Talibi shquhej për zgjuarsinë e rrallë, i pasionuar në zbulime e shpjegime, i përqendruar mbi rregullat e ligjet, i thelluar në kuptimin e tyre, depërtues deri në më të zakonshmet që të mos mbeteshin të panjohura për njerëzit. Mendimi i tij prej kolosi depërtoi thellë në rrënjët e shoqërisë, zbuloi të vërtetën e saj, atë të vërtetë për të cilën shprehet: "Nuk ka ndonjë të uritur të varfër, përveç se prej asaj me të cilën kënaqet i pasuri"; ose "Nuk kam parë ndonjë me bollëk të madh dhe që pranë tij të mos jetë një e drejtë e humbur". Ky ishte Imam Aliu i cili prej dhjetëra shekujsh zbuloi sekretin e humanizmit. Ky sekret ka lidhje me popullin, me pronarët, me pushtetarët për të vënë peshoren e drejtësisë për popullin, sepse ky ka kontribuar që ata të ngjisin shkallët e pushtetit. Ai fshikulloi në kohët e hershme privimin e të mirave nga të gjithë njerëzit, ushtrimin e dhunës ndaj masës dhe gjithashtu tregoi me gisht faktorët e të keqes, të poshtërimit e mashtrimit që maskohen me petkun

e pushtetit. Ky njeri i madh i kohërave çoi përpara të vërtetën e humanizmit, që është hyjnore, e vjetër që me fillimin e shoqërisë njerëzore dhe e qëndrueshme në përjetësi. Kjo e vërtetë vjen nga thellësia e absolute që përfaqëson sundimin e të vërtetës me të cilën duhet të bashkohet zemra e mendja si dhe morali që dalin prej tyre. Çdo pohim për absoluten është fuqi dhe njeriu bëhet shembull i kësaj fuqie në jetën e tij, në fitoret e humbjet e tij. Në të gjitha gjendjet ai duket i barabartë, sepse ajo është këtu dhe atje, ajo është mposhtësja dominuese në të cilën janë të barabarta triumfi dhe disfata në fushën e betejës, në fushën e politikës e në të gjitha fushat e tjera. Në triumf e në disfatë për atë, nuk ka gur prove, sepse vetë ajo mban të gjitha përmasat. Por besimi i fortë në absoluten, Zotin e Plotfuqishëm, kalon çdo vështirësi, triumfi i tij është i sigurt, sepse me të ai nuk bën pazare, nuk mashtron në zgjedhjen e preferuar.”

Gjurmë të Imam Aliut dhe të bektashizmit në Azerbaixhan, ishin idetë kryesore të studiuesit nga Azerbaixhani, Prof. Dr. Ali Shamil.



Duke u ndalur në këto gjurmë, ky shtoi: “Kaukazi që është një vend i pasur dhe me pasuri natyrore në shekujt që kemi kaluar disa herë është

kthyer në fushë lufte. Forcat politike në mesjetë kalimi i qeverive apo për konsolidimin forcave të tyre i kanë zbehur besimet e njerëzve. Dhe kjo nuk ka zgjatur pak. Në shekujt 18-20. në Kaukaz nuk ka ndodhur asnjë herë të vetme përplasje midis besimeve në komunitete apo shoqëri. Në Rusi më 25 Tetor 1917 (në kalendarin e ri 7 nëntor), bolshevikët me forcën e armëve që në ditët e para me të marrë në dorë qeverinë filluan të zbatojnë ligje të ashpra karshi besimeve. Kryetari i qeverisë së re Vladimir Iliç (Uljanov) firmosi dekretin e datën 5 shkurt të vitit 1917 “mbi ndarjen e kishës nga shteti dhe shkollës nga kisha”. Qeveria e re e krijuar në 28 prill të vitin 1920, me pushtimin e Azerbajxhanit pranoi dekretin e datës (15 Maj 1920) të Komisarariatit të Folklorit Popullor të Azerbajxhanit “Mbi Ndërgjegjen”. Gjatë periudhës së Republikës së Azerbajxhanit (1918-1920), u hoq Ministria ekzistuese e Fesë dhe u shpall ndarja e fesë nga shteti dhe fesë nga shkolla. Thuhej se qytetarët janë të lirë të besojnë në fe ose të mos besojnë në ndonjë fe. Në pamjen e parë, ky urdhër është shumë demokratik dhe funksionon. Bolshevikët me të konsoliduar forcat e tyre, ashpërsuan luftën kundër fesë. Viti 1922 konsiderohet fillimi i lufte së ashpër kundër fesë në Rusi i cili pati ndikim në Azerbajxhan. Në 12 Shtator të vitit 1923, në Moskë, Komiteti kundër fesë vendosi të formojë shoqata “Luftëtarë të Pa Fe”. Nën ndikimin e saj në vitin 1923 në “Klubin e Materialistëve” kishte dhe të tjerë nga drejtuesit e qeverisë së Azerbajxhanit si Samedaga, Ağamalıoğlu, Ruhulla Ahundov, Aliheyder, Garayev që u sqaronin njerëzve punëdashës faljen e namazit, vajtjen në Qabe dhe mendimet që ishin të huaja për zhvillimin shpirtëror dhe traditën.


...Në lindje të qytetit të Bakusë në brigjet e Detit Kaspik ndodhet qyteti i madh i Buzovn-ës. Në breg të detit një imam mbante emrin e Hazreti Ali.

Ai punoi si profesor në Universitetin Shtetëror të Bakusë. Në vitin 1919 ai shkruan për dijetarin e famshëm të shkencës Mirze Memmedaga: “Sipas tregimeve në vitin 13 hixhri në Absheron vjen një karvan i cili përshkon çdo vend pa u fshehur nga askush. Në breg të detit, ishte një nga dy vëllezërit që vinte shpesh nga Meka dhe Medina në Baku për të bërë tregti dhe që e njihte imamin. Ai pa në breg të detit karvanin dhe qëndroi i befashuar. I përlulur pyet kryetarin e karvanit:

- Jaa Ali, çfarë po bëni këtu ?

Ky, me zemërim për ata që e njohën një këmbë në yzengji, ngriti këmbën tjetrën nga vendi duke kalëruar, pyeti se ku e njihnin. Tregtari i bëri të ditur se ai erdhi nga Meka dhe Medina në Baku dhe e njihte prej andej Hazreti Ali. Imami ynë, i hipën kalit dhe largohet prej andej. Pasi ikën karvani njerëzit përreth panë një mrekulli; gjurmën e thundrave dhe këmbës së kalit mbi shkëmb të mbetura në vendin që imami i hipi kalit të tij.”

Nga Kosova erdhi kësaj radhe në eventin bektashian, baba Mumin Lamaj. Këndvështrimi i studimit të tij ishte sidomos në rrafshin e cilësive të prijësit të besimtarëve, kur bëhet fjalë për të ruajtur vlerat më të qenë-



sishme shpirtërore. Në fund të fjalës së tij, baba Mumin Lamaj tha: "Imam Aliu respekton specien njerëzore, të gjitha racat. Imam Aliu edhe pse ishte kështjella e Islamit dhe prijës i besimtarëve, kundërshtonte që ndonjë njeri të detyrohet të besojë në fenë që besojnë myslimanet. Sipas Imam Aliut, njerëzit janë të lirë të besojnë Zotin, secili sipas udhës së tij, me kusht që kjo të mos e fyejë komunitetin e të mos sjellë dëm mbi 'të, sepse të gjithë njerëzit janë nën përkujdesjen e Zotit. Cilësia 'njeri', është e mjaftueshme në vështrimin e Imam Aliut, që e bën njeriun të respektuar e të dashur, të shoqërohej me 'të, të kishtë meëshirë për 'të dhe të mos i mohojë asgjë e asnjë nga të drejtat që i takojnë. Mos u bëj i keq me njerëzit, sepse ata janë njëri nga dy llojet: ose vëllai i yt në fe, ose i ngjashëm me ty në krijim. Atëherë, çdo njeri ka të drejta, ashtu siç ke edhe ti, edhe pse ai ndryshon në disa gjëra në të cilat beson ti, ose ai ndryshon se i përket një feje tjetër. Me siguri që qëllimi yt është të lidhesh sa më shumë në lidhje vëllazërore me të tjerët. Kur ti e gjenë lidhjen e vëllazërisë vetëm në cilësinë e njeriut, patjetër që këtu nuk ka mëkat. Asnjëherë Imam Aliu

Vallë a është e mundur të arrihet harmonia fetare e dëshiruar, kur secili nga folësit e shikon shtrembër tjetrin? I shtrëngon atij dorën e djathtë, kurse vetë në atë moment kryqëzon gishtat e tij të dorës së majtë? Përgjigja është e qartë: Jo! Gabimi kryesor këtu është të kuptuarit e qëndrimit të tij si të qendrës dhe këndvështrimet e tjera si të periferisë, ku duke u bazuar të shkaqet e jashtme në një fare mënyre duhen arritur. E thënë ndryshe, një kuptim i tillë i dialogut ndërfaqetarak rrjedh nga qëndrimet e ekskluzivitetit dhe ajo asnjëherë nuk do të arrijë harmoninë ndërfaqetare të vërtetë, sepse gjithmonë do të bazohet te interesat e ndokujt. Duke u shprehur më thjeshtë, secili do ta tërheqë jorganin nga ana e vet. Një paradigmë të tillë të dialogut ndërfaqetarak mund të krahasohet me paradoksin, të cilin e kanë përmendur të mençurit e lashtë grekë dhe i cili deri sot e kësaj dite nuk ka gjetur zgjidhje.

nuk dëshiron që mendimin tënd ta bësh boshtin e gjykimit. Kufinj të jetës janë pa përmasa, tepër të gjerë dhe njerëzit janë ata që sillen në këtë gjerësi kaq të madhe. Imam Aliu thote qartë: "Kurrë mos e konsidero të pa rëndësishëm ndonjërin prej rrobëve të Allahut, sepse ai mund të jetë mik i Allahut dhe ti nuk e di". Këtu do të kuptojmë qëndrimin e tij të qartë ndaj fanatizmit dhe lirisë pa kufi. Njeriu, cilido qoftë besimi i tij, ka për detyrë të porosisë veten që lidhja e tij me tjetrin të jetë kështu: të dëshirojë



për tjetrin atë çka dëshiron për vete, dhe të mos dojë për tjetrin atë që nuk e do për veten e tij. Besimtari i vërtetë "Për të mirën nuk le qëllim pa arritur" dhe me e mira e të mirave është drejtësia te njerëzit, pa bërë dallim mes tyre. Nesë do të vemë ballë për ballë botën sipas udhës së Muham'edit, do të shohim se ajo nuk ndryshon nga bota e udhës së Mojsiut ose edhe nga udha e kujtdo që ka përvetësuar virtytet njerëzore. E rëndësishme në pikëpamjen e Imam Aliut, është afrimi te virtytet dhe në këtë drejtim njerëzit janë të lirë të zgjedhin. 'Në të dërguarin e Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij' është modeli më i mirë.

Një përvojë e harmonisë fetare, e frymëzuar prej imamatit dhe sidomos veprës së Imam Aliut, e cilësoi Prof. Dr. Damir Mukhetdinov, shembullin e Islamit në Rusi. Po cilat janë rrugët e ndjekura për të arritur tek kjo harmoni, cilat janë qëllimet dhe sfidat e sotme, sa të ndërgjegjshëm jemi për të përcjellë realitet hyjnor në realitete e këtij shekulli, kjo vlenë të gjykohej qetësisht. Midis të tjerave Prof. Dr. Mukhetdinov shtoi: " Nganjëherë, Imam Aliu thoshte: Le të zënë vend në zemrën tënde si mbështetja tek njerëzit ashtu edhe pavarësia nga ata dhe le të shfaqet mbështetja jote në mënyrën më të mirë të saj, në fjalën



e mirë, në komunikim me ta, kurse pavarësia nga ata le të ruajë dinjitetin tend". Vallë a është e mundur të arrihet harmonia fetare e dëshiruar, kur secili nga folësit e shikon shtrembër tjetrin? I shtrëngon atij dorën e djathtë, kurse vetë në atë moment kryqëzon gishtat e tij të dorës së majtë? Përgjigja është e qartë: Jo! Gabimi kryesor këtu është të kuptuarit e qëndrimit të tij si të qendrës dhe këndvështrimet e tjera si të periferisë, ku duke u bazuar te shkaqet e jashtme në një fare mënyre duhen arritur. E thënë ndryshe, një kuptim i tillë i dialogut ndërftuar rrjedh nga qëndrimet e ekskluzivitetit dhe ajo asnjëherë nuk do të arrijë harmoninë ndërftare të vërtetë, sepse gjithmonë do të bazohet te interesat e ndokujt. Duke u shprehur më thjeshtë, secili do ta tërheqë jorganin nga ana e vet. Një paradigmë të tillë të dialogut ndërftuar mund të krahasohet me paradoksin, të cilin e kanë përmendur të mençurit e lashtë grekë dhe i cili deri sot e kësaj dite nuk ka gjetur zgjidhje. Kam parasysh paradoksin e Akilit dhe breshkës: Akili njeriu më i shpejtë përpiqet t'ia kalojë breshkës, krijesës më të ngadaltë në tokë. Megjithatë, sado që përpiqet, ai nuk ia del dot, pasi mes tyre në çdo moment të kohës do të ketë një distancë të pafund të pakapërcyeshme hapësire, që krijon që në fillim një logjikë vicioze të lëvizjes. Kështu, edhe këtu: rruga e kompromisit të mesëm paraqitet si pa rrugëdalje, sepse kjo rrugë nuk ka fund dhe futet në vorbullën e pafund të shpjegimeve dhe llogarive, kush ka të drejtë e kush e ka gabim, ku secili i jep të drejtë vetes dhe të tjerët kanë humbur rrugën e tyre. Akoma më në qorrsoak ndodhet ai, që përpiqet të shtypë qëndrimet e tjera me ndihmën e forcës. Dhe shkrimi dhe historia dhe mençuria shekullore na kanë mësuar, që përshkallëzimi i dhunës së filluar, e cila shkakton shpesh viktima nuk ka fund tjetër, veçse asgjësimin e plotë ose vdekjen e pjesëmarrësve.

Por cili dhe në çfarë rasti është qen-

... Nuk është fort e lehtë të ruhen traditat në kohërat që kalojmë. Sepse është e vështirë sot, në kushtet e një jetë të strukturuar për hyjnizimin e të mirave materiale, të mendosh për pasurimin me vlera shpirtërore. Në këtë kontekst, mendoj se Selia e Shenjtë Bektashiane, këtu në Tiranë po bën përpjekje të admirueshme për të përligjur besimin e krejt komuniteteve bektashianë në të gjithë botën, duke qenë plot dinjitet në lartësinë e përgjegjësive të saj historike.

drimi ynë i vërtetë? Si mundet ne të arrijmë harmoninë fetare të vërtetë, pra jo vetëm të shmangim armiqësinë por edhe arrijmë dakortësinë rale, e cila nuk do të jetë një barazi e përgjithshme sipas standardit të jashtëm, por do të shpalosë unitetin e vërtetë në shumëllojshmëri?

Para së gjithash ne duhet të dëgjojmë atë që na është komunikuar neve nga vetë Krijuesi (Lavdi Atij). Është thënë: "Në të vërtetë, feja te Allahu është Islami (përrulla nga dëshira e Tij). Atyre, që i është dhuruar Shkrimi, kanë pasur mosmarrëveshje vetëm pasi ata kanë njohur zilinë për njëri tjetrin. Kush nuk i është bindur Allahut, shpejt Allahu do ta thërrasë për ta vënë para përgjegjësisë". Për më tepër, Kurani i Shenjtë thotë: "Ktheje fytyrën tënde te feja e vërtetë, e ardhmja e vërtetë. Allahu i krijojti njerëzit duke u bazuar te e vërteta. Allahu nuk bën ndryshime". Allahu në Kuran gjithashtu thotë: "Ata janë dëbuar padrejhtësisht nga shtëpitë e tyre vetëm sepse thanë: "Zoti ynë është Allahu". Nëse Allahu nuk do ti lejonte njerëzve të mbroheshin nga




të tjerët, atëherë do të ishin shkatërruar, kisha, xhamia, sinagoga, në të cilat kujtojnë emrin e Allahut. Allahu menjëherë jep ndihmë atij njeriu, që ndihmon Atë. Në të vërtetë, Allahu është i Gjithëpushtetshmi.

Ndonjë, ndryshe nga të tjerët, i cili beson ndryshe, por ashtu si ne vjen në paqe, por jo për të treguar krenarinë e tij. Edhe ne veprojmë në të njëjtën mënyrë me të. Prandaj, për të njohur veten, rëndësinë tone ne duhet që së bashku me të tjerët të miqësohemi. Përplasjet ndodhin vetëm sepse ne ende nuk e kemi kuptuar këtë gjë, nuk e kemi pranuar këtë të vërtetë në zemrën tonë. Prandaj, është i pamend ai që shkelmon të Plotfuqishmin. Asnjë nuk ka faj për atë që ndodh, përveç ne vetë. Krijuesit jo më kot na dërgon neve ndonjë dënim, pasi xhelatët më të mirë për veten jemi vetë ne. Pra, arsyeja kryesore e harmonisë fetare është pohimi i përgjithshëm, që fakti i mungesës së saj sot dhe mbretërimit kudo të ekskluzivizmit kanë lindur krenaritë, që kanë errësuar mendjet dhe zemrat e njerëzve. Më e rëndësishme është të kuptohet, se nëse fqinji yt, besimi i të cilit dallon nga besimi yt, beson në vërtetësinë dhe realitetin, beson ashtu si dhe ju, që do të thotë ju të dy besoni njësoj, besoni Krijuesin, që gjendet në zemrat tuaja. Harmonia fetare është ajo që ka lindur bashkë me njerëzit, mund të themi ajo është gjendja e tyre më të lartë fillestare. Prandaj dakortësimi nuk është aspak një pikë e largët për tu arritur, për në që jetojmë secili në

botën tone dhe që përpiqemi për ta realizuar atë. Në të kundërt, është një pike fillestare e ekzistencës tone nga ku ne duhet të kthehemi.”

Ndërsa Prof. Dr. Mesud Idriz nga Bosnja, u ndal sidomos në dimensionin dituror të prijësit të besimtarëve. Ai tha: “Shumë i nderuar Kryegjyshi Botëror Bektashian, Baba Edmond Brahimaj! Është hera e dytë që unë marr pjesë në këtë event të Selisë Bektashiane këtu në Tiranë dhe më lejoni të them komplimentet e mijë personale për ruajtjen e traditave të Islamit. Sepse nuk është fort e lehtë të ruhen traditat në kohërat që kalojmë. Sepse është e vështirë sot, në kushtet e një jetë të strukturuar për hyjnizimin e të mirave materiale, të mendosh për pasurimin me vlera shpirtërore. Në këtë kon-



Mezari i Imam Aliut a.s. - Irak

tekst, mendoj se Selia e Shenjtë Bektashiane, këtu në Tiranë po bën përpjekje të admirueshme për të përligjur besimin e krejt komuniteteve bektashiane në të gjithë botën, duke qenë plot dinjitet në lartësinë e përgjegjësisë të saj historike.

Bosnja, një shtet me më pak se 4 milion banorë, është një enë e madhe me ndjenja religjioze dhe sekulare. Sipas censusit të vitit 2000 popullata e Bosnjës përfshinë; rreth 48% Boshnjakë, 37% serbë dhe 14% kroatë. Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës siç edhe zyrtarisht është e njohur, është e ndarë në dy pjesë autonome. Boshnjakët janë të bashkuar me Boshnjakët kroatë në federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, kurse serbët sundojnë pjesën të cilën e morën gjatë luftës e quajtur Republika Srpska. Më poshtë do të shohim relacionin e tyre si myslimanë me turqit dhe arabët. Siç kemi përmendur më lartë se me ardhjen e Sulltan Mehmed Fatihut erdhi edhe islamit në Bosnjë je po atë shek-



ull, sufizmi ndihmoi në shpërndarjen e religjionit. Mes tyre më të njohurit ishin nakshibendinjët dhe alvetinjët. Një nga sufistët e parë që ka ardhur në Bosnje në mes të shekullit XIV-të ishte Sari Salltuk, anëtarë i tarikatis bektashinj. Dy sufistë tjerë të njohur ishin Ayni-Dede dhe Shemsi-Dede, të cilët formuan qendrën mësimore sufiste për tarikatin bektashi afër Fojnicës. Imam Aliu është njeriu i tyre. Boshnjakët potencojnë se njohja me personalitetin e Aliut, është njohja e njeriut perfekt në Islam. Në Bosnje dokumentohet të kenë ekzistuar rreth 10 teqe, por mendohet se numri ishte më i madh. Ekzistojnë këta tarikate në Bosnje: rufai, odiri, makshibendi, shalidhi dhe tarikati mevlevi. Tarikatet dallojnë vetëm në performimin dhe praktikimin e tyre por në esencë qëndrojnë të njëjtë. Bektashinjët i morën parimet e shiiave rreth shekullit 15 duke përfshirë nderimin e Aliut, si pasues i katërt i profetit Muhamed. Për të parë dashurinë që boshnjakët ndjenjë për Aliun, do t'i shohim përmes të thënave të tyre dhe se si ata e shprehin dashurinë ndaj Aliut. Aliu ka qenë një ndër personalitetet që ka poseduar fuqinë e tërheqjes dhe fuqinë e veprimeve ushtarake, dhe të dyja këto veti i kishte shumë të zhvilluara. Aliu ka pasur shoqëri të vërtetë, të besueshëm dhe të gatshëm për të flijuar. Prej kohës së këtij imami të nderuar kanë kaluar shumë vite

por personaliteti i tij shkëlqen ende. Boshnjakët ndajnë dashuri të madhe për Aliun sepse shkollat shia kanë qenë dhe mbeten shkolla të dashurisë. Një nga cilësitë e shkollave shia është se ajo kujdeset për dashurinë e të tjerëve. Elementin e dashurisë e përshkruan shi'izmi. Dashuria për Aliun nuk ka ekzistuar për shkak të pamjes fizike të tij, sepse ai nuk jeton më, por Aliun e duan sepse ai është shembull i manifestimit të dijes dhe të vërtetës. Mevlana për Aliun ka thënë se ai është "Luani i Zotit".

Islamin dhe në veçanti bektashizmin, Dr. Lale Algyn-Turqi, e kishte konceptuar nga një këndvështrim interesant. Një material i vlershëm dhe i mjaftueshëm i disa anketave serioze në Gjermaninë e sotme, bëri të mundur që të pranishmit të njiheshin sa me tendencat e Islamit në Perëndim, aq edhe me mënyrat e vështrimit dhe perceptimit të qytetarëve perëndimor ndaj këtyre myslimanëve që të detyruar të braktisin atdheun dhe kulturën e tyre identitare, u nënshtrohen rregullave dhe ligjeve të reja. Në këtë studim u prekën edhe probleme të qëndrimeve të ndryshme të emigrantëve ndaj zhvillimeve të sotme në Gjermani.

Ka qenë dervish Abdyl Mutalib Beqiri-Maqedoni, i cili në fjalën e tij u ndal më së shumti në dashurinë dhe përultësinë e prijësit të besimtarëve ndaj krijuesit. Më tej ai vijoi: E prita me kënaqësi të veçantë ftesën e organizatorëve për të marrë pjesë në këtë konferencë ndërkombëtare dhe lus Zotin e Lartë t'ia arrijmë qëllimit dhe të hedhim sa më shumë dritë diturie dhe dashurie për Imam Aliun,



... Është e vërtetë që imami ynë ka pasur dashuri të thellë për Ehli-Bejtin, për ndjekësit e tij, për njerëzit e urtë dhe të ndershëm, për besimtarët dhe fakirët, por kur bëhet fjalë për dashurinë ndaj Zotit, ai vërtetë qëndron shumë lart. Në ato lartësi të besimit, shumë elementë mistikë janë gati të panjohur për njerëzit e zakonshëm. Ka ardhur mjaft bukur kjo cilësi e vyer e Imam Aliut, përmes perceptimit të autorit të njohur Xhorxh Xhordan, i cili thotë se në çdo gjë që ka lidhje të afërt ose të largët me qenien e njeriut e me jetën e tij të brendshme, të cilën individi e përfytyron dhe e ngjyros me forma e ngjyra të dala prej tij, ose që janë arritur prej lidhjeve të tij me mjedisin përkatës. Imam Aliu, edhe pse ishte zëvendësuesi i Profetit, kështjella e Islamit dhe prijësi i besimtarëve, kundërshtonte me forcë të madhe që ndonjë njeri të detyrohet të besoj në fenë që besojnë myslimanët. Sipas tij, njerëzit janë të lirë të besojnë Zotin ashtu si ata mendojnë dhe secili të besojë sipas rrugës së tij, me kusht që kjo të mos fyejë komunitetin e të mos sjellë dëm mbi të, sepse të gjithë njerëzit janë nën përkujdesjen e Allahut, kurse feja është veprim i ndërsjellë.

alekum salam. Për mua, si për çdo klerik bektashian, nuk ka dyshim se fjala dhe mendimi i këtij imami, kanë udhëhequr bektashizmin në të gjitha kohërat, në të gjitha vendet e botës.

Në shikimin e parë, tema e dashurisë së Krijuesit, brenda Imam Aliut, m'u duk diçka jo fort e vështirë. Por sa më shumë thellohesha në buriimet e shkruara, sa më shumë pashë rrëfimet e klerikëve bektashianë për jetën e tij, sa më shumë meditova, aq më e vështirë m'u duk kjo tematikë. Sepse është e vërtetë që imami ynë ka pasur dashuri të thellë për Ehli-Bejtin, për ndjekësit e tij, për njerëzit e urtë dhe të ndershëm, për besimtarët dhe fakirët, por kur bëhet fjalë për dashurinë ndaj Zotit, ai vërtetë qëndron shumë lart. Në ato lartësi të besimit, shumë elementë mistikë janë gati të panjohur për njerëzit e zakonshëm.

Ka ardhur mjaft bukur kjo cilësi e vyer e Imam Aliut, përmes perceptimit të autorit të njohur Xhorxh Xhordan, i cili thotë se në çdo gjë që ka lidhje të afërt ose të largët me qenien e njeriut e me jetën e tij të brendshme, të cilën individi e përfytyron dhe e ngjyros me forma e ngjyra të dala prej tij, ose që janë arritur prej lidhjeve të tij me mjedisin përkatës. Imam Aliu, edhe pse ishte zëvendësuesi i Profetit, kështjella e Islamit dhe prijësi i besimtarëve, kundërshtonte me forcë të madhe që ndonjë njeri të detyrohet të besoj në fenë që besojnë myslimanët. Sipas tij, m njerëzit janë të lirë të besojnë Zotin ashtu si ata mendojnë dhe secili të besojë sipas rrugës së tij, me kusht që kjo të mos fyejë komunitetin e të mos sjellë dëm mbi 'të, sepse të gjithë njerëzit janë nën përkujdesjen e Allahut, kurse feja është veprim i ndërsjelltë.

Cilësia njeri, është e mjaftueshme në vështrimin e Imam Aliut, që e bën njeriun të respektuar dhe të dashur, të shoqërohej me të. Të kishte mëshirë për të dhe të mos i mohojë asgjë e asnjë nga të drejtat që i takojnë. Në letrën që i dërgonte guvernatorit

të tij në Egjipt, imami ynë i thoshte: 'Kurrë mos u bëj bishë me njerëzit, që u rrëmben atyre ushqimin, sepse ata janë njeri nga dy llojet: ose vëllai yt në fe, ose i ngjashëm me ty në krijim. Jepi atij faljen e çiltërsinë tënde, ashtu siç dëshiron të të japë Allahu ty prej faljes e çiltërsisë së Tij dhe kurrë mos u pendo për faljen që ofron dhe kurrë mos u krekos me dënimin që jep.'

Atëherë, çdo njeri ka të drejta. Pse ai ndryshon në disa gjera në të cilat beson ti dhe ti ose ai ndryshon se i përket një feje tjetër. A nuk është qëllimi yt të lidhesh sa më shumë me lidhje vëllazërore? Kur ti e gjen lidhjen e vëllazërisë vetëm në cilësinë e njeriut, pa tjetër që në këtë nuk ka mëkat. Përkundrazi, është vëllazëri e bekuar nga Allahu.

Në të gjithë gjendjet, Imam Aliu nuk dëshiron që mendimin tënd ta bësh boshtin e gjykimit dhe matësin absolut në ndonjë punë të jetës apo të njerëzve. Kufijtë e jetës janë pa përmasa, tepër të gjera dhe njerëzit janë ata që sillen në këtë gjerësi kaq të madhe. Nuk duhet t'i japësh vetes më shumë rëndësi seç duhet, që gjykimi yt të jetë fjalë e parë dhe e fundit për veprimet e njerëzve.... Imam Aliu thotë një fjalë të qartë: 'Kurrë mos e konsidero të parëndësishëm ndonjërin prej robve të Allahut, sepse ai mund të jetë mik i Allahut dhe ti nuk e di'. Nëse ti e mbart këtë fjalë të urtë deri në horizontet e saj të largët, do të kuptosh qëndrimin e tij të qartë ndaj fanatizmit dhe lirisë pa kufi.

Kur vëllai yt është në gabim ose punon keq, detyra jote është t'i japësh atij faljen dhe çiltërsinë tënde. Kurrë mos u pendo që fale e u tregove i çiltër. Përsëri detyra jote është 'të korrësh të keqen prej zemrës së tjetrit me shkëlqim që i bën ai asaj prej zemrës tënde'. Njeriu, cilido qoftë besimi i tij, ka detyrë të porosisë veten që lidhja e tij me tjetrin të jetë në atë mënyrë që atë që dëshiron për vetë, t'a dëshiroj edhe për tjetrin dhe të mos dojë për tjetrin atë që nuk e do për vetë. Pra, misioni është 'Duaje për veten atë

çka do për veten tënde. Mos duaj për tjetrin atë çka nuk e do për veten tënde dhe kënaqi njerëzit me atë çka ti je i kënaqur prej tyre'.

Nëse do të vendosësh ballë për ballë, sipas rrugës së Muhamedit, do të shohësh se ajo nuk ndryshon në asnjë send nga bota e rrugës së Mesijhut ose edhe nga rruga e kujt do që ka përvetësuar virtytet njerëzore. E rëndësishme në pikëpamjen e Aliut, është afrimi te virtytet dhe, për sa i përket miteve, në këtë drejtim, njerëzit janë të lirë të zgjedhin. 'I Dërguarit e Allahut- paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi 'të e mbi familjen e tij- është modeli më i mirë, për imamin tonë. Ai kishte hequr dorë nga të mirat e kësaj bote, kishte lënë mënjane pijet që bota ofron dhe prej tij ishin hequr gjithë zbukurimet. Unë mund të them të njëjtat fjalë edhe për Isanë, të birin e Merjemit, paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi të. Ky vinte gurin për jastëk, vishte rroba të zakonshme, hante gjëra të thata, gjithnjë ishte i uritur. Llamba e tij gjatë natës ishte hëna, hijet kur pushonte ishte toka e hapur, frutat e lulet aromatike për të ishin bimësia që toka nxirrte për bagëtinë. Ai nuk kishte grua që ta tundonte, as fëmijë që ta turpëronin, as pasuri që ti merrte mendjen, as ambicie që ta poshtëronin! Mjet lëvizje për të ishin vetëm këmbët e tij dhe shërbyes për të ishin vetëm dy duarët e tij.

...Edhe liria e besimit në fe është një prej të drejtave të njeriut në kushtetutën e Imam Aliut. Liria nuk copëtohet dhe njeriu nuk mund të jetë i lirë nga njëra anë dhe i kush-tëzuar nga ana tjetër.

Myslimani është vëlla i kristianit, do apo nuk do. Sepse njeriu është vëlla i njeriut, e do apo e urren. Sikur në kushtetutën e Aliut të mos ishte afrimi te virtyti, matësi bazë në lidhje me lirinë, atëherë liria e nderuar kurrë nuk do të ishte tek ai një e drejtë e shenjtë. Ky e konsideronte vëllazërinë në besime apo fe të ndryshme si dashuri ndaj vetë Krijuesit.

Miq të nderuar!

Unë bëj pjesë sot në vargun e gjatë të dervishëve dhe baballarëve bektashianë, të teqesë së “Harabati-Babës”. Vetëm pak javë më parë ne festuam 480 vjetorin e ngritjes së kësaj teqeje, të njohur në krejt Ballkanin si për përcjelljen e mësimëve të Zotit, ashtu dhe për ndjenjat e kulluara nacionaliste. Natyrisht në pesë shekuj veprimtarie, kjo teqe është përballur me lloj-lloj shtrëngatash qofshin ateiste, qofshin të llojeve të tjera. Por ne ja kemi dalë se përveç të tjerave, klerikë dhe besimtarë në krejt Maqedoninë, jemi përpjekur ta duam Krijuesin me po atë devocion e dashuri të thellë si të prijësit të besimtarëve.

Ju faleminderit!

Eposi bektashian për veprën e prijësit të besimtarëve, ishte ideja e kumtesës së Dr. Blerina Harizi. Një studim i mirëfilltë, bazuar në arkiva ballkanike por edhe në historitë e këtyre trevave, solli tek të pranishmit ndjesinë se mirënjohja e bektashinjve ndaj Imam Aliut është përcjellë nga brezi në brez. Ndër të tjera, Dr. Harizaj u shpreh: “Kjo traditë e Tiranës, besoj se do të shpjerë sa më larg, vëmendjen botërore ndaj bektashizmit. Imam Aliu, ky personalitet i botës islame vazhdon edhe sot e kësaj dite të frymëzojë besimtarët bektashianë, të cilët me një admirim të pashoqë duan të ecin në rrugën e “Mbretërit të diturisë” apo në rrugën e “Mbretit të besimtarëve”. Një figurë e nderuar e bektashizmit, Baba Rexhepi do shprehej kështu: “Bektashizmi admiron profetin Muhamet si ndriçues botëror i dritës islame dhe i kushton një respekt të madh të Madhit Ali, i cili i frymëzuar nga profeti Muhamet me frymën mistike islame është ai që e pajisi botën islame për herë të parë me njohuritë dhe dritën mistike. I madhi Ali këtë dritë hyjnore ua la trashëgim fëmijës profetike, imamëve me radhë, gjë që u trashëgua brez pas brezi deri më



Baba Rexhepi do shprehej kështu: “Bektashizmi admiron profetin Muhamet si ndriçues botëror i dritës islame dhe i kushton një respekt të madh të Madhit Ali, i cili i frymëzuar nga profeti Muhamet me frymën mistike islame është ai që e pajisi botën islame për herë të parë me njohuritë dhe dritën mistike. I madhi Ali këtë dritë hyjnore ua la trashëgim fëmijës profetike, imamëve me radhë, gjë që u trashëgua brez pas brezi deri më sot.” Dashuria për profetin Muhamed nënkupton edhe dashurinë për Imam Aliun, vetë profeti ynë do të linte këto urdhra; “Dashuria për Alinë dhe fëmijën profetike është një cilësi që shlyen çdo të metë të besimtarit. Atë që të dashuron ty, o Ali, e vesh Zoti me rrobën e besimit dhe të shpëtimit. Gjëja që mbush faqen e të mirave për besimtarin është dashuria për Alinë dhe familjen profetike.” Ndaj edhe sot besimtarët bektashianë përulen me nderimin më të madh para kësaj figure të shenjtë, simbol i dashurisë, bujarisë, drejtësisë dhe lumturisë. Për jetën dhe veprën e Imam Aliut, studiuesi Reshit Hajllamaz do shprehej:” Personaliteti i Aliut nuk ndryshoi kurrë, ai mbeti i njëjti person pavarësisht situatave që ndodhnin rreth tij. Koha nuk e ndryshoi atë, vetëdija dhe devotshmëria karshi Zotit, pati marrë nën kontroll botën e tij, ndaj në marrëdhënie me njerëzit ai nuk vepronte sipas ndjenjave, por sipas vlerave të përcaktuara nga Zoti dhe i Dërguari i tij. Ky qëndrim nuk ndryshoi madje as gjatë betejave.

sot." Dashuria për profetin Muhamed nënkupton edhe dashurinë për Imam Aliun, vetë profeti ynë do të linte këto urdhra; "Dashuria për Alinë dhe fëmijën profetike është një cilësi që shlyen çdo të metë të besimtarit. Atë që të dashuron ty, o Ali, e vesh Zoti me rrobën e besimit dhe të shpëtimit. Gjëja që mbush faqen e të mirave për besimtarin është dashuria për Alinë dhe familjen profetike." Ndaj edhe sot besimtarët bektashianë përulen me nderimin më të madh para kësaj figure të shenjtë, simbol i dashurisë, bujarisë, drejtësisë dhe lumturisë. Për jetën dhe veprën e Imam Aliut, studiuesi Reshit Hajllamaz do shprehej; "Personaliteti i Aliut nuk ndryshoi kurrë, ai mbeti i njëjti person pavarësisht situatave që ndodhnin rreth tij. Koha nuk e ndryshoi atë, vetëdija dhe devotshmëria karshi Zotit, pati marrë nën kontroll botën e tij, ndaj në marrëdhënie me njerëzit ai nuk vepronte sipas ndjenjave, por sipas

vlerave të përcaktuara nga Zoti dhe i Dërguari i tij. Ky qëndrim nuk ndryshoi madje as gjatë betejave. Edhe në ditët kur shpërndante mijëra dinarë për bamirësi, Aliu do mbështillte belin me gurë për të përballuar urinë. Gjithmonë mendonte për të tjerët." Për të gjithë ata që besojnë te ai, Imam Aliu vazhdon të shpërndajë perlat e mençurisë, duke mishëruar njëherësh bujarinë, durimin, urtësinë hyjnore dhe veprat e mira. "Profeti i njeriut -do shprehej vetë Aliu, është interpretuesi i intelektit të tij." Për Imam Aliun, gjëja më e çmuar në jetë ishte liria e njeriut, në raport me veten dhe botën, ndaj edhe sot na kumbojnë shumë aktuale thëniet të tij të urta për këtë liri. Pikërisht burimin e këtyre fjalëve të mençura e gjejmë në dashurinë dhe bujarinë që ai tregoi përgjatë jetës së tij, ndaj njerëzve. Ai do të thoshte, "ruaju të mos preferosh veten në ato që njerëzit i kanë model", duaj për tjetrin atë që do për veten tënde

dhe urre për tjetrin atë që urren për veten tënde" dhe "mos jji skllav i një tjetri, Zoti të ka bërë njeri të lirë." Ndaj le të përulemi me nderimin më të madh ndaj këtij personaliteti, që përfaqëson në vetvete një anë të madhe të drejtësisë dhe dashurisë universale, dhe modelin më të mirë të njeriut që nuk kurseu as veten dhe jetën për të mirën e njerëzimit. Ndiqja e tij -do shprehej studiuesi Xhorxh Xhordak, ka qenë e madhe në të gjitha fushat e jetës duke ndihmuar në uljen e rezistencës së mizorit, të padrejtë, duke ndihmuar të dhunuarin nga padrejtësia, prej kundërshtimit të së vërtetës, skllavërimit, shfrytëzimit të punës duke shembur shkaqet e padrejtësisë e duke vendosur rregullat e ligjet kushtetuese. Ka sakrifikuar në rrugën e fisnikërisë njerëzore atë që është më e shtrenjtë, gjakun dhe jetën."

Koresp. "Urtësia"



Etyd nga 22 marsi



Nuk kanë marrë asnjë ftesë të veçantë askush. Por kanë pasur sigurisht brenda vetes, ftesën (jo në formën e saj klasike prej letre) se duhej bërë diçka për ditëlindjen e Imam Aliut, paqja qoftë mbi 'të. Janë drejtuar për në Selinë e Shenjtë Bektashiane në Tiranë, duke dëshmuar vullnetin e paepur se kjo ditë e madhe vlenë të jetohet ndryshe. "Kisha tërë ato punë, më tha Rakipi nga Luzi i Kavajës. Se kamë gjithë atë tokë, kam fruta dhe po mbjellë perime. Me ato mbahemi. Po të rrija në

Luz, nuk do dija nga t'ia filloja sot. Ama tërë natën nuk fleta. Se jam myhib, jam në tarikat. Po mirë ja, unë u kujdesa për baçen, po kush do vinte në Tiranë? Jo se nuk ka të tjerë, jo. Po ish ditëlindja e Imam Aliut. Ne që jemi të tarikatit nuk mund të merremi me baçet tona dhe të vijnë të tjerët e të urojnë për 22 marsin.! Prandaj u çova në 5 në sabah dhe tani jam këtu. U takova edhe me myrshidin tim, dede Reshatin, atje tek mezari. U takova edhe me baba Mondin. Ne myhibët jemi të shtëpisë. Ne duhet me prit e përcjellë njerëz sot."

Kanë ardhur nga Bllaca e largët e Dibrës. Më thanë se ishin mësuar të shkonin çdo 22 mars në teqenë e baba Ismailit. Por ai u shua përpara pak kohësh dhe teqeja hesht sot e kësaj dite. Heshtja i vret këta besimtarë bektashinj, një mijë herë më shumë se trishtimi i thellë ndaj kanë marrë rrugën për në Tiranë. Kanë ardhur nga Vlora. "Vajç tek dede Ahmeti dhe pak te dede Reshati, më thotë një myhib i vjetër, Fetah Xhemalaj. U shmalla me 'ta. E di si më duket? Sikur nuk jemi në vitin 2018. Sepse jo vetëm unë, por ec në tyrbe dhe e kupton se të

gjithë llafosin me ata dy dedelerë , ja sikur të ishin gjallë në këtë botë.” Kanë ardhur nga Gjirokastra dhe sjellin së bashku me këngën labe mallin e baba Selimit dhe të baba Rexhebit, krenarinë për baba

kthen fytyrën drejt njerëzimit. Ti ecën me dinjitet. Ti largon nga mendimi yt çdo ambicie lavdie dhe fame. Ti përulësh në shërbimin e Krijuesit. Ti pastron çdo të keqe nga shpirti dhe e forcon atë



Ali Tomorin dhe baba Shefqet Koshtanin. Emra baballarësh të ndritur që ndonëse koha tinëzare që kaluam i veshi me mjegull, gjithsesi nuk i shoi dot. Mjegulla e rëndë në disa dekada u davarit dhe shenjtorët bektashianë erdhën sërish në mejdanet e tyre, në ata të teqeve dhe të shpitrave tanë.

Sepse në shpitrat e besimtarëve, vendi i Zotit dhe i myrshidit janë gati të shenjta. Më erdhi ndërmend Sanai i famshëm kur thoshte se nëse më pyet dikush se kush janë shenjat e tarikatit unë do ti përgjigjesha drejt dhe qartë. Ti e

me arsyetim. Ti nuk ia ke nevojën shtëpisë së atyre që mbahen me të madhe, por të atyre që mbahen nga urtësia. Ti sheh vetëm të vërtetën dhe largohesh përfundimisht nga gjërat e kësaj bote. Pra ti kalon në botën e mistereve për të arritur në gjirin e varfërisë. E kur ti të jesh miku i varfërisë, shpirti yt do të bëhet i penduar. Paskëtaj Zoti do të nxjerrë përgjithmonë varfërinë nga zemra jote dhe vetëm Ai do të rrijë i ndritur atje.

Himni i flamurit na kujton të gjithëve se tarikati bektashian i ruan të shenjtë, pranë njeri-tjetrit

Haxhi Dede Edmond Brahimaj thotë: “Mirë se keni ardhur në festën tonë, në festën e gjithë shqiptarëve, në ditën e Sulltan Novruzit. Zoti i Lartë e shpërbleftë besimin tuaj dhe paçi vetëm fat dhe harmoni në shtëpitë tuaja! Sulltan Novruzi është festa që vjen prej qindra shekujsh dhe bektashinjë e gjithë botës urojnë me shpirt që kjo festë të vazhdojë edhe qindra shekuj të tjerë. Sepse është dita e pranverës, dita e ringjalljes së natyrës, dita e gëzimeve që mbulon teqetë dhe shtëpitë tona. Kjo ditë lidhet ndërkaq me ditëlindjen e profetit të besimtarëve, Imam Aliut, aleqym selam, i cili me jetën dhe veprën e tij, mbetet sot e kësaj dite modeli njerëzor dhe hyjnor nga duhet të udhëhiqemi të gjithë, mbeti busulla e pagabuar në udhëkryqe të historisë fetare.

dashurinë për Haxhi Bektash Veliun dhe atdheun. Kryegjiysi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj thotë: “Mirë se keni ardhur në festën tonë, në festën e gjithë shqiptarëve, në ditën e Sulltan Novruzit. Zoti i Lartë e shpërbleftë besimin tuaj dhe paçi vetëm fat dhe harmoni në shtëpitë tuaja! Sulltan Novruzi është festa që vjen prej qindra shekujsh dhe bektashinjë e gjithë botës urojnë me shpirt që kjo festë të vazhdojë edhe qin-



dra shekuj të tjerë. Sepse është dita e pranverës, dita e ringjalljes së natyrës, dita e gëzimeve që mbulon teqetë dhe shtëpitë tona. Kjo ditë lidhet ndërkaq me ditëlindjen e profetit të besimtarëve, Imam Aliut, aleqym selam, i cili me jetën dhe veprën e tij, mbetet sot e kësaj dite modeli njerëzor dhe hyjnor nga duhet të udhëhiqemi të gjithë, mbeti busulla e pagabuar në udhëkryqe të historisë fetare.

Të gjithë ju që keni ardhur sot këtu, por edhe qindra mijëra besimtarë të tjerë që mbushin sot oborret e teqeve, nga Azia në Amerikë dhe Kanada, me siguri ndajnë gëzimin dhe shpresën që përcjell kjo ditë, përmes bisedave tuaja, lutjeve tuaja, lutjeve tuaja, këngëve tuaja, bashkudhëtarë me një shpresë të re. Ju merrni ndërkaq së bashku me urimet për njeri-tjetrin edhe uratat tona, të klerikëve bektashianë që kemi bërë dhe bëjmë ç'është e mundur t'u qëndrojmë pranë halleve, dertëve dhe aspiratave tuaja. Një urim i veçantë shkon sot, për besimtarët bektashianë në Maqedoni, të cilët sikundër gjithë shqiptarët atje fituan të drejtën e të folurit dhe të shkruarit të gjuhës shqipe zyrtarisht, duke na gëzuar të gjithëve ne. Gjithashtu një urim për mbarësi shkon tek besimtarët dhe krejt populli i Kosovës, me rastin e votimit në Parlament të ligjit të demarkacionit me Malin e Zi. Ëndrra e shqiptarëve për të trokitur në dyerët e Europës, po bëhet realitet."

Këngët dhe vallet mbushin sheshin dhe shpirtat tanë.

Kishte menduar për ta festuar krejt ndryshe kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Veliaj ditën e 22 marsin, Festën e Sulltan Nevruzit. Pas urimit të Tij, si edhe bisedave të këndshme me Kryegjyshin Botëror Bektashian ata iu drejtuan mjedisit pranë Odeonit madhështor dhe mbollën aty disa pemë duke i shtuar hijeshinë këtij vendi. Zoti Veliaj u shpreh



Ndërsa Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij Ilir Meta vijon: “Është një privilegj i veçantë që ndodhem sot këtu, në kryeqendrën botërore të besimit bektashian për të ndarë së bashku me ju harenë dhe mesazhet optimiste të festës së shenjtë të Sulltan Novruzit. Shembulli frymëzues i Imam Aliut, filozofia, përpjekjet dhe sakrificat e tij sublime, si dhe roli e kontributet e qenësishme të bektashinjve shqiptarë në rrjedhën e historisë, përbëjnë garanci për të tashmen dhe të ardhmen jo vetëm të këtij besimi, por edhe të gjithë shoqërisë sonë. Kjo histori e ky shembull krijon më shumë besim dhe jep më shumë optimizëm jo vetëm për ne, por sidomos për brezat e rinj dhe të ardhmen e paqme të tyre. Në këtë ditë pranverore, pamja madhështore që ofron ky shesh dhe kjo kryeqendër botërore me Selinë e Shenjtë të Bektashizmit, e sidomos prania juaj e nderuar, nxjerrin më shumë në dritë dhe reflektojnë akoma edhe më fort vlerat e jashtëzakonshme të harmonisë e bashkëjetesës së paqte mes besimeve

fetare në Shqipëri.

Dija, urtësia dhe drejtësia janë tipare të patjetërsueshme, të cilat kanë karakterizuar dhe çuar përpara bashkësinë bektashiane ndër shekuj, të ndërthurura harmonikisht me ndjenjën e palëkundur të atdheadashurisë së pashtershme. Pikërisht ky besim dhe këto vlera të spikatura, përcjellja e tyre brez pas brezi, mbeten jo vetëm një shembull i veçantë mbarë botëror por sidomos një garanci se ato do të vazhdojnë të trashëgohen edhe në të ardhmen në shërbim të shoqërisë, vendit dhe atdheut tonë të dashur. Këto vlera, veçanërisht sot, në këtë ditë të shenjtë të Bektashizmit, marrin një dimension shpirtëror e tokësor njëkohësisht si një busull orientuese drejt shpresës, optimizmit, paqes e harmonisë mbarë fetare, jo vetëm në Shqipëri.

Kjo ditë e bukur dhe ky manifestim i kapërcen kufijtë e kësaj kryeqendre botërore, edhe kufijtë tanë kombëtarë, duke dhuruar mesazhe të qarta mbi rëndësinë e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit mes besimeve fetare, mes etnive, mes kombeve dhe mes vendeve, për të ndërtuar së bashku një botë të paqte dhe për të dhuruar më shumë dashuri mes njerëzve, më shumë mirëkuptim në gjirin e familjes dhe më shumë optimizëm në zemër të shoqërive tona moderne.

Sot shpirti dhe zemrat tona mbushen me ndjenja të ripërtëritura qetësie e gëzimi për të falur dashamirësi, vëllazëri dhe bashkëpunim pa kursim, për të mirën tonë të përbashkët, për të ardhmen tonë të përbashkët dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë. Besimi i palëkundur në të plotfuqishmin Zot dhe në mësimet e shenjta, i bën mirë cilitdo. Besimi i patundur në Atdheun tonë të përbashkët, në të ardhmen e tij të ndritur si dhe në vlerat përbashkuese kombëtare, na bën mirë të gjithëve, na bën më krenarë e më të bekuar të gjithë bashkë, si shqiptarë!

Duke uruar nga zemra në këtë ditë hareje, shprese dhe optimizmi fetar e pranveror, dëshiroj t’ua përcjell këtë urim mbarë popullit shqiptar dhe besimtarëve bektashianë kudo në botë!

Gëzuar Festën e Sulltan Novruzit! Paçi gjithmonë shëndet e mbarësi në familjet tuaja! Paqja dhe mirësia mbretërofshin nga hera në zemrat dhe shpirtrat e çdo familje shqiptare dhe të çdo shqiptari!”



midis të tjerave se kjo ditë që simbolizon ndërrimin e stinëve dhe në mënyrë të veçantë ardhjen e pranverës le të mbetet e përjetëshme në gjelbërimin e këtyre pemëve. Nga ana e tij Kryegjyshi Botëror Bektashian, e falënderoi duke dhënë fjalën se klerikët bektashianë kudo ku janë në të gjithë qytetet e Shqipërisë do të kujdesen në mënyrë të pandërprerë për gjelbërimin e vendit.

Veprimtaritë e kësaj dite të bekuar i ka mbyllur promovimi i librit “Vlerat e vërteta të ujit” të autorit japonez Masaro Emoto. Nuk ka munguar persiatjet e shkrimtarëve të shquar tanë rreth librit sikundër dhe falënderimet e veçanta të ambasadorit japonez Shkëlqesia e Tij Makoto Ito në Tiranë. Ndërsa Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u shpreh me këtë rast:

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Të nderuar studiues, intelektualë dhe besimtarë bektashianë!

Më lejoni që së bashku me urimin për festën e Sulltan Novruzit, t’ju uroj mirëseardhjen në këtë takim, me dëshirën e madhe për fat e mbarësi në çdo familje tuajën.

Zoti i Lartë e shpërbleftë devocionin tuaj ndaj besimit fetar në përgjithësi dhe veprimtarive të Selisë së Shenjtë Bektashiane në veçanti.

Personalisht, e prita me mjaft kënaqësi botimin e librit “Fuqia e Vërtetë e Ujit” të autorit japonez Masaru Emoto, të përkthyer në mënyrë dinjitoze prej zonjës Merita Doniku. Jo thjeshtë për informacionin që do të marrin lexuesit. Jo thjeshtë për të kundruar dhe medituar rreth mendimit të thellë të autorit

Emoto. Por më së shumti, për t’iu bashkuar nismës së marrë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, në lidhje me të sotmen dhe perspektivat zhvillimore të ujit. Prandaj bëme ç’ishte e mundur që ky libër të dilte në dritë, duke kontribuar edhe si Seli e Shenjtë Bektashiane në këtë hulumtim serioz botëror.

Pavarësisht se në fletët e librit flitet më së shumti për problemet e ujit në Japoni, ne gjykojmë se mesazhet që ai përcjellë, kanë vlera universale. Një prej këtyre mesazheve është padyshim se fuqia e vërtetë e ujit, përveç të tjerave ka mundësi të ndryshoj trupat dhe mendjet tona, duke na afruar energji pozitive edhe në kohëra me andralla. Në një kuptim më të thellë, tendencat e shkencëtarëve që merren sot me problemet e fuqisë së ujit, na bashkohen dhe ne klerikëve të çdo feje dhe besimi, në misionin e madh për sendërtimin e shoqërisë njerëzore me devocionin ndaj Krijuesit. Prandaj më lejoni të shpreh edhe një herë konsideratën më të lartë për ideatorët dhe ata që aktualisht punojnë për zhvillimin e pandërprerë të energjive tona ujore.

Të nderuar miq!

Siç mund të jeni në dijeni, besimi ynë bektashian, qysh në lindjen e tij para 800 vitesh, tradicionalisht e zhvillon veprimtarinë e vet fetare, njerëzore dhe sociale, në mjediset e teqeve. Këto mjedise, jo rrallë, janë shndërruar në shkolla të edukimit fetar, të edukimit shkollor, por edhe të dashurisë për natyrën, sepse Zoti është dhe mbetet krijuesi i saj, i Vetëm dhe i Plotfuqishëm. Brenda këtij konteksti, vlerat e fuqisë së ujit janë përcjellë nga koha në kohë, nga vendi në vend, nga brezi në brez. Kopshtet e teqeve, sidomos në Turqi, Armeni, Azerbajxhan, Bullgari, Greqi, Bosnjë, Kosovë dhe sidomos në Shqipëri, në këta shekuj, janë kthyer tamam në prehtore fizike dhe shpirtërore. Myhibët dhe dashamirësit tanë, të udhëhequr nga urtësia e dervishëve dhe baballarëve, në respekt të punimit të tokës deh vaditjes së këtyre bahçeve, kanë parë fuqinë e ujit, si fuqi jetëdhënëse, duke iu bashkuar ndonëse pa e ditur, armatës së njerëzve të shkencës në këtë udhëtim drejt mirësive njerëzore. Edhe një herë ju faleminderit të gjithëve dhe shpreh bindjen e thellë se kontributi ynë i sotëm është një gurë themeli në përkujdesjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për fuqinë e vërtetë të ujit.

Zoti ju bekoftë të gjithëve!

Syrja Xhelaj

Nderim për dede Reshat Bardhin

Busti i tij vendoset në qendër të qytetit të Ballshit



Nga Kujtim BORIÇI

Si rrallë herë, në 4 marsin e këtij viti, qyteti i Ballshit dhe gjithë Mallakastra, kanë përjetuar një ditë të veçantë festive që lidhet me dy evenimente të rëndësishme, pelegrinazhin vjetor tradicional në teqenë bektashiane të Greshicës

si dhe ceremoninë e vendosjes së bustit të klerikut dede Reshat Bardhi në qendër të qytetit të Ballshit, me vendim të Këshillit Bashkiak të këtij qyteti. “Vendosja e bustit të myrshidit tim, dede Reshat Bardhi në qendër të qytetit të Ballshit, është jo vetëm vlerësim për kontributin e këtij kleriku bektashian, por dhe për vetë besimin tonë që ka devizën ‘Pa fe nuk ka atdhe’ dhe po gjejnë shtrirje në Shqipëri e

mbarë botën, duke shtuar përditë e më shumë armatën e tetëmilion besimtarëve tanë në gjithë globin. Dua të shpreh mirënjohje dhe të bekoj me këtë rast Këshillin Bashkiak të Ballshit, Kryetarin e Bashkisë, Agron Kapllanin për këtë vendim dhe vlerësim për bektashizmin, si dhe besimtarin Kujtim Jazar që krahas të tjerave, mundësoi financiarisht ndërtimin e kësaj vepre”- shton mes të tjerave



“Dede Edmond Brahimaj:Vendosja e bustit të myrshidit tim, dede Reshat Bardhi në qendër të qytetit të Ballshit, është jo vetëm vlerësim për kontributin e këtij kleriku bektashian, por dhe për vetë besimin tonë që ka devizën ‘Pa fe nuk ka atdhe’ dhe po gjejnë shtrirje në Shqipëri e mbarë botën, duke shtuar përditë e më shumë armatën tetë milion besimtarëve tanë në gjithë globin. Dua të shpreh mirënjohje dhe të bekoj me këtë rast Këshillin Bashkiak të Ballshit, Kryetarin e Bashkisë, Agron Kapllanin për këtë vendim dhe vlerësim për bektashizmin, si dhe besimtarin Kujtim Jazar që krahas të tjerave, mundësoi financiarisht ndërtimin e kësaj veprë”

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

Dita përmblihte dy aktivitete të njëpasnjëshme: Cemoninë tradicionale vjetore të 4 marsit të pelegrinazhit në teqenë e Greshicës si dhe atë të përrimit të bustit të dede Reshat Bardhit në qendër të qytetit të Ballshit. Ky aktivitet masiv, si rrallë ndonjëherë, kishte mbledhur besimtarë vendas, të ardhur nga trevat shqiptare

brenda e jashtë kufirit, klerikë bektashianë të këtyre trevave, përfaqësues të të gjithë forcave politike dhe besimtarë të shumtë. Ishin të pranishëm gjithashtu dhe Kryetari i Bashkisë së Mallakastrës Agron Kapllani, deputeti Enkeleid Alibeaj e funksionarë të tjerë shtetërorë. Në të dy ceremonitë, fjalën përshëndetëse, e mbajti Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili, mes të tjerave tha:

“ Është kënaqësi e veçantë për mua të marr pjesë në gëzimin e kësaj dite këtu në qytetin e Ballshit në vendosjen këtu në qendër të qytetit të bustit të dede Reshat Bardhit.... Më lejoni t’ju kujtoj të gjithëve sot se më 5 nëntor të vitit 2009, ndërsa vizitonte teqenë e Drizarit, dedei ynë Reshat Bardhi, do të thoshte midis të tjerave në fjalën e tij: “Tek populli i vuajtur i Mallakastrës, ne klerikët bektashianë, gjetëm jo vetëm mikpritjen e trashëguar nga brezi në brez, por edhe forcën tonë për të besuar, se dera e Haxhi Bektash Veliut, nuk do të mbyllej kurrë”. Ai e deshi Mallakastrën me po atë dashuri siç deshi Kukësin që e lindi, siç deshi Tiranën, që ndonëse punoi për 25 vjet punëtor krahu, gjeti kohën e na priti ne, besimtarëve ilegalë, duke mbajtur në shpirtrat tanë, të pa fikur dhe të palëkundur besimin në Zot. Prandaj vendosja e bustit të tij në sheshin e qytetit tuaj, është një vlerësim jo vetëm për klerikët bektashianë, jo vetëm për sakrificat e tyre në shërbim të Zotit dhe kombit, por edhe një gjest qytetarie, me anë të të cilit ju respektoni sot brezat e besimtarëve në krejt Mallakastrën. Gjej rastin të falënderoj me respektin më të madh Këshillin Bashkiak të Mallakastrës, vëllanë tonë dhe tuajin Agron Kapllanaj si dhe zotin Kujtim Jazar për kontributin e vazhdueshëm të tij në ringritjen e objekteve tona të kultit.”

Pas kryegjyshit Botëror Bektashian, përshëndeti Kryetari i Bashkisë së Ballshit, Agron Kapllanaj. “Ndjehem tejet i lumtur sot, se më së fundi, ne mallakastriotët, nderojmë klerikun bektashian, dede Reshat Bardhin, që mes të tjerave, ka qenë mes nesh, në teqenë e Drizarit për



10 vite, në një kohë të vështirë, duke lënë gjurmë të pashlyera si klerik e si njeri. Por dhe më pas, në ringritjen e besimit e institucioneve bektashiane në Shqipëri e jashtë saj. Pra, me ngritjen e bustit në qendër të qytetit, ne si Bashki bëmë detyrën tonë, por që duhet theksuar dhe kontributi i rëndësishëm i dede Edmond Brahimajt dhe bashkëqytetarit tonë Kujtim Jazaj në financimin e ngritjes së bustit”- shtoi ai.

Më pas, përshëndeti deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, Enkelejd Alibeja. Ndër të tjera ai tha: “Jam i lumtur që marr pjesë në këtë eveniment të rëndësishëm në mirënjohje e vlerësim të ish-Kryegjyshit Botëror Bektashian, dede Reshat Bardhi, njeriut që punoi në një kohë tejtër të vështirë në Drizar, por të theksoj dhe një mesazh të mirë që na japin ne me këtë vendim dhe pjesëmarrje në aktivitet, banorët e Mallakastrës, atë të mirësisë, vëllazërisë, bashkimit të njerëzve pa dallim bindje fetare e politike, në të mirë të

vetes së tyre, shoqërisë e vendit. Dua të përshëndes me këtë rast Kryegjyshin Botëror dede Edmond Brahimaj për punën e palodhur në forcimin e besimit bektashian dhe mesazhet e unitetit, mirësisë, paqes e lirisë, si elementë të domosdoshëm për shtimin e besimit në Zot dhe forcimit të ndjenjës së atdhetarisë.”

Pas tij përshëndeti të pranishmit dhe ish-deputeti Pirro Lutaj: “Vendosja e bustit të dede Reshatit në qendër të qytetit tonë dhe kjo pjesëmarrje e madhe në nderim të tij, pa dallime partiake e fetare do të theksoja, është një mesazh i qytetarëve për të gjithë ne, për më shumë dashuri e mirësi”-pohoi Lutaj. Ndërsa në esencë, në fjalën e tij të shkurtër, biznesmeni Hajredin Fratari, vuri në dukje rolin e tymuar të dede Reshatit për bektashizmin dhe krenarinë si mallakastriot për vlerësimin që i bënë atij me vendosjen e bustit në qendër të qytetit.

Kujtim Jazaj, ndër të tjera pohoi: “Në Greshicë e Mallakastrën tonë,

për gati një dekadë, dede Reshat Bardhi shërbeu pranë myrshidit të tij dede Ahmet Myftarit, në atë kohë tejet të vështirë, duke qenë burim këshillash e shprespash për të ardhmen, përballë vështirësive të shumta që u solli jeta... Me vendosjen e bustit të tij në qendër të qytetit të Ballshit, dede Reshatin do ta kemi më pranë. Dua të shpreh mirënjohjen me këtë rast për, Kryegjyshin

Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili me punën e përkushtimin e tij në shërbim të besimtarëve bektashianë në gjithë botën, përherë e më shumë po shton radhët e besimtarëve, duke predikuar paqen, atdhetarinë, mirësinë dhe dashurinë për njeritjetrin, si dhe për Këshillin Bashkiak të Mallakastrës dhe Kryetarin e Bashkisë, Agron Kapllani për vendimin dhe vendosjen e bustit të dede Reshatit!”

E gjithë dita e bekuar, ishte një festë për qytetin e Ballshit. Ceremonia e zbulimit të bustit të dede Reshat Bardhit, u shoqërua me një program të grupit folklorik të Mallakastrës, përgatitur enkas për këtë eveniment. Në këtë mënyrë, aktivitetet së dielës në këtë qytet, me një pjesëmarrje masive në ‘to, nën një kohë me rreze dielli e ngrohtësi natyrore, sollën më tepër paqe e dashuri mes të pranishmëve, më shumë shpresë e besim tek Zoti si dhe më tepër reflektim e angazhim për më mirë në të ardhmen.

Prill në zemra



Nga Syrja Xhelaj

Tanimë, çdo fillimprilli përbën një ngjarje për bektashinjtë kudo ku janë. Ndonëse i larguar nga kjo botë shtatë vite më parë, ndjesia se është pranë nesh, na pushton të gjithëve. Dede Reshat Bardhi, çdo ditë e më shumë, na vjen pranë me bekimet e tij, me prillin shpërthyes në zemra.

...Itinerari i detyrueshëm familjar, e sjell djaloshin Reshat Bardhi, nga

Lusna në Tiranë. Në rastet më të zakonshme, përveç një oguri të bardhë, kjo rutinë e modeluar sipas togfjalëshit “për një copë bukë” nuk paralajmëronte diçka tjetër. Por ndryshonte puna në itinerarin shpirtëror. Asnjë lëvizjen e detyruar material, nuk ngjitej dot në të fshehtat e djalit nga Lusna. Ndonëse ndiqte mësimet në shkollën shtatëvjeçare, ai, netët e verës i kalonte në kodrat pranë Selisë së Shenjtë Bektashiane. Kishte takuar dervish. Kishte

bërë muhabetë me baballarë. Pati dëgjuar nga goja e baba Sulejman Hodos, i cili përcillte për mirësi fjalët e Ebu Hasan Nuriut, sipas të cilave, bektashizmi, është të heqësh dorë nga të gjitha kënaqësitë. Edhe ato thelbësore, edhe ato formale. ... Heqja dorë nga kënaqësia është një akt burrërorë. Ndërsa shuarja krejt e kënaqësisë, është një akt hyjnor.

Marrja dorë e tij në vitin 1951, është padyshim një ngjarje e madhe. Një lloj përpjekje men-

dore ose "philosophia divina", kish mundur të depërtonte në thellësi të shpirtit dhe mendjes së tij, duke zbuluar bashkëjetesën e teologjisë me filozofinë bektashiane. ... Ndërsa konsakrimi si dervish i Reshat Bardhit, në 22 shtatorin e vitit 1954, është në një farë kuptimi, tërheqje pas të fshehtave të mëdha. Dervishët vijne në natën e tyre të mejdanit, jo vetëm si interpretues dhe zbatues të denjë të formulave të betimit, por gjithashtu si njerëz që e kanë përmbushur misionin tokësor të tyre.

...Por më duhet të kujtoj këtu në këto rreshta, se prej erërave që frynin në Shqipërinë politike të saj kohe, bektashizmi, ashtu sikundër edhe fetë e besimet e tjerë, nuk mund të liheshin të lirë dhe të 'pa shtërnguar' në misionin e tyre. Vëmendja shtetërore kishte nisur, qysh me miratimin e një dekret-ligji në parlamentin shqiptar të vitit 1949, ku feja vihej nën kontrollin e plotë dhe absolut të qeverisë. Kishin nisur në masë të gjerë burgimet, dënimet deri dhe në vdekje të klerikëve nën falsitetin grotesk të akuzave dhe luftës pa kompromis të ideologjisë fetare. Çdo lloj lëvizje me karakter fetar pse jo të tillë, në komunitetet tradicional, vrojtohej përmes kaleidoskopit politik të totalitarizmit. Pra, dervish Reshat Bardhit, i duhej të zgjidhte midis dervishit të lëkundur prej erërave dhe furtunave shpirtërore dhe atij të traditës apo klerikut pa bujë, që merr përsipër të kryej misionin e tij, deri në sakrificën sublime. Kthim prapa nuk mund të kishte për



Ndonëse vrundujt e absurdit të kohës e flakën së bashku me myrshidin e tij, dede Ahmet Myftarin, në Drizar të Mallakastrës, ai nuk u tkurr shpirtërisht. Në mënyrë krejt intuitive, duke kërkuar nëpër etnitetet para kozmike të mesazheve të dymbëdhjetë imamëve, duke u mbështetur në traditën e mrekullueshme të bektashizmit shqiptar, këto dy patriarkë e shndërruan teqenë e Drizarit në një fole të besimit të kthjellët dhe besimit të dliirë. Të dashuruar pas një ezoterizmi stoik, në nëntë vitet e qëndrimit të tyre në atë humbëtitë shpirtërore, ata mundën jo vetëm t'u mbijetonin grackave të ish-sigurimit shtetëror, por mundën të zbresin në tokë mirësi të Zotit, për të dëgjuar, për të parë dhe zgjidhur hallet e besimtarëve mallakastriotë.

'të. Ndonëse sapo kishte trokitur në derë të Zotit. Në bektashizëm, po u ktheve pas natës së mejdanit, jeton jetën fizike si një kufomë e pakallur në varr.

Ndonëse vrundujt e absurdit të kohës e flakën së bashku me myrshidin e tij, dede Ahmet Myftarin, në Drizar të Mallakastrës, ai nuk

u tkurr shpirtërisht. Në mënyrë krejt intuitive, duke kërkuar nëpër etnitetet para kozmike të mesazheve të dymbëdhjetë imamëve, duke u mbështetur në traditën e mrekullueshme të bektashizmit shqiptar, këto dy patriarkë e shndërruan teqenë e Drizarit në një fole të besimit të kthjellët dhe

besimit të dliirë. Të dashuruar pas një ezoteri: mi stoik, në nëntë vitet e qëndrimit të tyre në atë humbëtorë shpirtërore, ata mundën jo vetëm t'u mbijetonin grackave të ish-sigurimit shtetëror, por mundën të zbresin në tokë mirësi të Zotit, për të dëgjuar, për të parë dhe zgjidhur hallet e besimtarëve mallakastriotë.

Një shembull domethënës që mund të ndriçojë sadopak atë antë të gjatë të qëndrimit në Drizar, është biseda në teqe në vitin 1962, nga një bektashian i viseve shqiptare të Strugës, i cili fshehurazi i kishte sjellë fjalët e baba Rexhebit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës: "Nuk do fiket qiriri i Haxhi Bektashit, sado erë të fryjë. Qëndroni të pastërt. Forcën ua japin erenlerët".

... E çuditshme është se si kishin ardhur fjalët e shenjtorit bektashian shqiptar, në teqenë e Detroit-Miçigan, baba Rexhebit, në kohën kur radarët e sofistikuara në kufijtë e Shqipërisë politike, ishin të ndjeshëm edhe ndaj fluturimit të zogjve. Por nëse thërrasim për ndihmë madhështinë e Gazulit të dikurshëm, mund të ripërsërisim mendimin se bota e dukshme, mbetet ende si pikënisje drejt botës të mbretërisë qiellore. ...Pandehma e partisë-shtet se me dërgimin në internim të dy klerikëve bektashinj, kundërshtarë të hapur të ideologjisë së saj, do të fashitej ajo drej-drite e fesë, rezultoi e gabuar. Si rral-lëkund në historinë e bektashizmit shqiptar dhe atij

botëror, mijëra besimtarë bektashianë, ndonëse me vetëdijen e sulmuar prej ideologjive të lindura mijëra kilometra larg tyre, hapur apo fshehurazi dëshmuar mbështetjen ndaj dedeit, ish-partizan i Brigadës së Parë Sulmuese dhe dervishit besnik nga Kukësi. Ky akt, nuk mund të shihet si i veçantë, përkrah një kon-tinuiteti tradicional dhe në dimensione shenjtërie, të dashuruesit për Të Dashurin...

Në mesinë qindra besimtarëve të ardhur nga krejt Ballkani, Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj thotë:

" Në historinë 800 vjeçare të besimit bektashian, emri i dede Reshat Bardhit do të mbetet padyshim, sinonim i një mbijetese të shkëlqyer. Ndërsa në panteonin e ndritur të baballarëve dhe dedelerëve, ai qëndron kurdoherë frymëzues, për milionat e besimtarëve dhe ndjekësve bektashianë. Pak kush si ai, në rrjedhën e rrëmbyer të ngjarjeve në Shqipëri e Ballkan, pas viteve 60 të shekullit që lamë pas, jo vetëm që diti të orientoj drejt, jo vetëm që nuk lejoj nëpërkëmbjen fizike dhe morale të atyre që besonin në Zot, por u shndërrua vetë në një institucion të mëshirës universale, duke pritur rrufe e shkrepëtime mbi vete, si malet e Kukësit, ku pati lindur dhe ishte rritur.

Në konceptin tim, dede Reshat Bardhi i ka kaluar mrekullisht, të gjitha etapat, jo vetëm tradicionale



por edhe morale e hyjnore, çka besimi ynë të ofron. Qysh në konsakrimin e tij si dervish, ai u vu në provën e vështirë dhe të dhimbshme. A do të degdiset me myrshidin e tij, dede Ahmet Myftarin në teqenë e rrënuar të Mallakastrës, apo do ta braktiste atë, për të fituar tek qeveria e kohës dhe për t'u ngjitur më tej, në shkallët e larta të karrierës. Ai tregoi devotshmërinë karakteristike, të përcjellë prej dervishëve bektashianë.

Në vitin famëkeq 1967, pikërisht në këto momente aq të rëndësishme dhe gati përcaktuese për fatin e bektashizmit në Shqipëri, unë pata fatin e madh të takohem me këtë mistik të rrallë. Dede Ahmet Myftari, kushëriri i parë i tim 'eti, Hysenit, erdhi në tetorin 1967 në shtëpinë tonë, i shoqëruar nga dede Reshati. Ne jetonim në Tiranë në një shtëpi të vogël me dy dhoma e kuzhinë, e cila, çuditërisht disa kohë më vonë, do të rritej e rritej, sa për të mbledhur dhjetëra besimtarë bektashianë. Dede Ahmetin ne e thërrisnin 'Babamadhi'... Unë vetë kam ardhur në jetë, prej frymës së Babamadhit... Në fillim të viteve 70-të, një dhomë e shtëpisë tonë nuk çelej. Ishte dhoma e Babamadhit dhe dervishit... Mund të tingëlloj si diçka e çuditshme, por në ato net veprimtarish e praktikash fetare në fshehtësi të plotë, nën kujdesien e drejtpërdrejtë të dervish Reshat Bardhit, ne mundëm të kishim një dritare më shumë në realitetin e ndotur

prej ateizmit të kohës.... Me mençurinë dhe urtësinë karakteristike të tij, dervish Reshat Bardhi diti të përcjellë tek ne mesazhet më të pastra të orientimit mistik, i vetëdijshëm për të nesërmen tonë.

...Në fillim të viteve 1990, jeta ime u mbështet e tëra në vëmendjen e dede Reshatit... I tillë që ky kujdes për mua, në natën e 22 marsit 1991, ndërsa merrja dorë me gëzimin e madh, se do të shërbeja në rrugë të Hakut... Vetëm një vizionar si dede Reshati, mund të ideonte dhe ringrinte bektashizmin, në lartësinë ku jemi sot. Pa vizionin e tij, vështirë të ringrihej besimi në këto përmasa të sotme në Mal të Zi, Kosovë e Maqedoni...

...Shumë dijetarë bektashianë, bashkohen me idenë se çdo prijës shpirtëror, është shembëlltyrë e myrshidit. Çdo myrshid i sotëm, dikur ka qenë një nxënës që ka adhuruar deri në përlulesi, mësuesin e vet shpirtëror. Ky zinxhir, hallkat e të cilit na çojnë shekuj më përpara, duket se na trondit kur mendojmë se myrshidi i parë i yni, është Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të. Duke ju falur Atij, ne bektashinjtë të sotëm, s'na mbetet gjë tjetër veçse t'i afrohem me përgjërime hap pas hapi, jetës dhe veprës së Reshat Bardhit. Të ngjitemi sa më lart, tek ky mal hyjnor si fatlumë që jemi, për të kapur sinjale, nga qiejt e shenjtërisë së tij.



Përgjegjësi më të mëdha mbi veten

Parlamenti Libanez dhe Asambleja Interparlamentare për Orthodoksinë, në bashkëpunim me Bashkimin Ndërparlamentar Arab, organizuan në mjediset e Parlamentit, në Bejrut një Konferencë Ndërkombëtare me idenë “Diversiteti në unitet dhe liritë themelore për të krishterët dhe myslimanët në Lindjen e Mesme”, në datat 3-4 prill 2018. I ftuar në këtë event ishte dhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili u prit me respekt nga përfaqësuesit

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Diversiteti në unitet dhe liritë themelore për të krishterët dhe myslimanët në Lindjen e Mesme”, të organizuar në Bejrut.

Libisë z. Nahib Berri, i cili duke sjellë realitetet e trishta në Lindjen e Mesme, theksoi rëndësinë e një bashkëpunimi afatgjatë dhe konkret, të niveleve më të lartë të përfaqësimit të krishterëve

tërheqës aktivitetin. Liderë fetarë si dhe parlamentarë libanezë, në vijim sollën jo vetëm përvojat e tyre, por edhe ide se si mund të përballohen situatat që kalojmë. Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, duke marrë fjalën në këtë event tha midis të tjerave: “Është nder dhe kënaqësi e veçantë për mua, të marr pjesë në këtë Konferencë dhe t’ju përcjell në emër të komunitetit bektashian botërorë, urimet më të mira për ju dhe familjet tuaja! Zoti i Lartë na e shpërbleftë devocionin tonë në rrugëtimin e gjatë shpirtëror drejt paqes universale!

Sigurisht, tema e sotme rreth diversitetit në unitet dhe lirisë themelore për krishterët dhe myslimanët në Lindjen e Mesme, merr një rëndësi të veçantë në sfondin e ndezur të luftërave me karakter fetar, racor apo etnik. Perceptimi im personal është se këto “vatra të ndezura”, më shumë se konfliktet



më të lartë të Parlamentit Libanez si dhe sekretariatit ndërkombëtar të Ansamblesë Orthodokse.

Në ceremoninë e hapjes së Konferencës, u prit me interes fjala e Kryetarit të Parlamentit të

dhe orthodoksëve të këtij rajoni, çfarë mund të sjellë një paqe të qëndrueshme. Më tej, një vizitë në mozaikët e lashtë të Malit Athos, si dhe njohja me mrekullitë shpirtërore atje, e bënë akoma më



sipërfaqësorë ndërjetarë, mbahen të tillë, nga faktorë ekonomik dhe gjeostrategjik, nga forca dhe interesa të ndryshëm, nga lakmia e pandreqshme dhe e përjetshme për pasuri tokësore. Në këtë këndvështrim do të thosha se kontributi ynë, i liderëve fetarë në krejt rajonin e Lindjes së Mesme, kërkohet të marrë mbi supë përgjegjësi si një institucion përfaqësuesi akoma më të mëdha në funksion të shuarjes së flakëve dhe masave për afrimin e një paqeje sa më të qëndrueshme.

Ne pajtohemi pa më të voglën mëdyshje me idenë se parlamentarizmi si një institucion përfaqësues i qytetarëve dhe vend i formulimit të kërkesave të tyre fetare dhe politike, ka rolin kryesor në ruajtjen dhe pasurimin e traditave dhe indentiteteve shpirtëror të popujve. Ndërkaq ne nuk mund të themi se, urat lidhëse midis parlamenteve dhe aspiratave shpirtërore të popujve që përfaqësojnë, janë mbi themele të çeliktë dhe të pacenuara nga asnjë rrezik, qoftë ky i brendshëm apo i jashtëm. Në këtë pikëpamje mendoj se Konferenca e sotme, përmes diskutimeve do të mund të arrijë të ndërmarrë nisma konkrete, veçanërisht në instalimin e qëndrueshëm të besimit tek Krijuesi si dhe lidhjen e tij me shoqërinë civile.

Lindja e Mesme, deri para disa dekadash ka manifestuar dëshminë e një bashkëjetese normale në aspektin shpirtërorë, ku çdo fe apo besim, i ushqyer nda devocione besimtarësh, ka mundur të udhëtoj gjatë në shekuj. Prirjet për ta quajtur vëlla me atë çfarë Zoti i Lartë të ka bashkuar, ndonëse prej race apo ngjyre të ndryshme, kanë konsistuar pikërisht

Lindja e Mesme, deri para disa dekadash ka manifestuar dëshminë e një bashkëjetese normale në aspektin shpirtërorë, ku çdo fe apo besim, i ushqyer nda devocione besimtarësh, ka mundur të udhëtoj gjatë në shekuj. Prirjet për ta quajtur vëlla me atë çfarë Zoti i Lartë të ka bashkuar, ndonëse prej race apo ngjyre të ndryshme, kanë konsistuar pikërisht tek bashkëjetesa fetare, koncepti i cili, pavarësisht se është vullneti i Zotit, mbahet fort në këmbë edhe prej natyrës njerëzore. Ka qenë kjo një ndër arsytet që rajoni në fjalë me kombet dhe qytetërimet e veta, i ka dhënë botës së dikurshme shembuj të vlerave të mëdha shpirtërore dhe morale.

tek bashkëjetesa fetare, koncepti i cili, pavarësisht se është vullneti i Zotit, mbahet fort në këmbë edhe prej natyrës njerëzore. Ka qenë kjo një ndër arsytet që rajoni në fjalë me kombet dhe qytetërimet e veta, i ka dhënë botës së dikurshme shembuj të vlerave të mëdha shpirtërore dhe morale.

Ndërsa realiteti i sotëm në këtë rajon është jo vetëm ngjethës, por edhe i trishtueshëm në kuptimin e perspektivës. Drita në anën tjetër të tunelit nuk po duket dhe veçanërisht në Siri, vandalizmat nuk kanë të mbaruar. Mijëra të pafajshëm kanë gjetur vdekjen në rrënojat e qyteteve, ndërsa qindra mijëra të tjerë po trokasin fort nëpër dyert e Europës, jo për hir të zbatimit të paketës ligjore për të drejtat e njeriut, por për hir të shenjtërisë së jetës që Zoti na jep për të gjithë ne. Ata po largohen në rrugë pa kthim dhe Europa, përpara se të bëjë llogari të ftohta me përqindje krishterësh dhe myslimanësh, vlen të japë ndihmën energjike dhe solidaritetin njerëzor, duke mirëkuptuar sakrificat sublime të këtyre njerëzve.

Mendoj se sot më shumë se kurrë, duhen parë në sy të vërtetat e mëdha, larg politizimit të besimeve dhe feve. Të vërtetat që kalojnë përmes ngjarjeve që i shohim me sytë tanë, që i prekim me duart tona, që i ndajmë me shpirtrat tanë. Sa më e rëndë të jetë pesha e të vërtetës në supet e seicilit prej nesh, aq më shumë do të mendojmë dhe jetojmë dramë që luhen në 'kampin' e kundërshtarëve të përkohshëm. Postulati i famshëm se "jetën ta fal Zoti dhe ai ta

merr, duke të përcjellë në jetën e përtëjme, duhet në çdo moment të na çojë në mbrojtjen e të pafajshmëve. Ne bektashinjtë, me besimin 800 vjeçar, ruajmë si një emblemë dliresie, qëndrimin e fëmijëve të pafajshëm që u masakruan në tokën e zhuritur të Qerbelasë shekuj më parë, vetëm e vetëm se ata iu bashkuan kauzës së Imam Hysenit, paqja qoftë mbi 'Të. Por ne nuk dëshirojmë asnjëherë që Lindja e Mesme të shndërrohet në një Qerbela të kohërave moderne, për shkak të interesave dhe lakmive të grupeve të oligarkëve financiarë, apo gjeo-strategjive politike.

Së fundmi, duke i uruar kësaj konference që të ndriçojë parlamentarizmin në prioritet dhe vizionin e tij, në lidhje me parimet demokratike të kohezionit social, do të dëshiroja që të kemi një kuptim më realist dhe vlerësim më tolerant në mbështetjen dhe forcimin e besimeve dhe feve tradicionale, të bindur për rolin e tyre

të jash.ëzakonshëm në udhëtimin historik të çdo vendi. Shembulli i Shqipërisë, shembulli i kombit tim në këtë kontekst është jo vetëm domethënës në vetvete, por edhe civilizues në të njëjtën kohë, për kombet e tjerë. Duke mbështetur, mbrojtur e çuar përpara tiparet më të vyer të trashëgimisë sonë fetare ne afrohemi më shumë me njeri-tjetrin, ne bëjmë më shumë për njëri-tjetrin, ne kontribuojmë njëherësh për harmoninë dhe bashkudhëtimin ndërfitar, por edhe për paqen universale, Ju faleminderit të gjithëve!"

Në ditën e dytë të Konferencës, përshëndeti gjithashtu Presidenti i Republikës së Libanit, Shkëlqesia e Tij, Michel Aoun, i cili u ndal me sfidat me të cilat përballen sot njerëzit në Lindjen e Mesme, si dhe rrugët e mundëshme politike për zgjidhjen e krizës. Më tej u diskutua rreth projektit të një deklarate të përbashkët, e cila përcaktoi se: duke dëshiruar të kontribuojmë në konsolidimin e

konceptit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duke njohur nevojën e një politike konstruktive, duke dashur të shmangim fenomenet e fundamentalizmit fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm që godet rajonet e botës, ne deklarojmë se: parlamentarizmi mbetet një faktor me rëndësi në ndërmjetsimin midis popujve. Prandaj vlen të shihet më mirë themelimi i dialogut të forumeve, si me institucionet parlamentare, ashtu edhe me komunitetet fetarë. Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos atyre fetare, Parlamentet do të amrrin nisma të tilla si: ndarjen e burimeve për aktivitete ndërgjegjësuese për çështje të lidhura me fenë, afrimi i minoriteteve në organet parlamentare për mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe aktivizimin e diplomacive fetare në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtarë.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, gjatë ditëve të Konferencës, bisedoi gjithashtu me z. Ziad Habib, guvernator i Bejrutit, Prof.Dr. George Suha përfaqësues i lartë i minoriteteve të Armenisë, z. Naamatallah Abi Nasr, deputet i Parlamentit Libanez, Akademik Asaf Hajjiev, si dhe Dr.Valery Pirogov, Sekretar i Përgjithshëm i Institutit të Athos Ruse. Në këto biseda ata u njohën midis të tjerave me veprimtaritë botërore bektashiane, veçanërisht në rrafsh të kërkimit dhe vendosjes së paqes universale.

Koresp. "Urtësisë"



Moj teqe e Durballisë



nga Luman Caka
.....

Moj teqe e Durballisë,
Ç'e bëre namin që pate,
Trëndafil i bektashisë,
Kujt ia le ato irate?

Durballi Sulltani ç'humbe,
Në Thesali u trete,
Flamurin e bektashizmit,
Ti swrish I mbart me vete.

Tërë pasuritë që pate,
Si kripa në ujë u tretën,
Në kope me irate,
Nëpër Thesali të mbetën.

Qiparisë e baballarë,
Teqenë s'e lanë vetëm,
Ranë një nga një me radhë
Si ushtarë dhe u tretën.

Njëri pastjetrit u thanë,
Baballarë e qiparisë,
Kohët e lavdisë mbaruan,
Viteve të prapësisë.

Kur gurët e fundit binin,
Nga ajo teqe e rrallë,
Shpirti i baba Seitit,
Rënkoi sikur të ishte gjallë.

Në teqenë që bëri emër,
Nuk bie më daulle e bukës,
Dhe kandilët dritëshumë,
Ngrinë rrethepërqark sufrës.

Durballi emri të mbeti,
Këngë e bukur nëpër vite,
Jehoi një dallgë deti,
Si feniks me rreze drite.

Sot flamur i bektashizmit,
Valvitet mbi kontinete,
Dhe emri i Durballisë
Ndrin si nur viseve greke.

Vdiq e shkoi armiqësia,
Fllad i paqes fryn kudo,
Do të ngrihet Durballia,
Zjarr mbi hirin, domosdo.

Selia jonë, bektashiane,
Durballinë e ka në zemër,
Siç e ka mbarë bektashizmi,
Durballi Sulltanë me emër.

Në 95 vjetorin e kalimit nga jeta të dervish Ilias Kulmakut

Falte vetëm dashuri

Nga Nuri Çuni

Dervish Iljasi në fizionominë fizike e shpirtërore ishte interesant. Trup mesatar, i imtë, sytë e vegjël, i shkëlqenin, sy të ndritshëm si vetëtim, të kaltër e ndriçues plot gjallëri, por edhe gjallëri shpirtërore, të brendshme. Tek ai, në pamjen e parë të binte në sy fytyra e thatë, e hequr, me mjekër dhe trup mesatar,



thatanik. Siç shkruan gazetarja zviceriane Hélène Pittard-Dufour: "Me këtë vetmi të linte përshtypje të çuditshme. Por gradualisht duke e parë mirë, dhe nga afër, fytyra e tij kishte plotësi të mbushur me një dritëz të ëmbël dhe dukej se zëri i tij vinte nga ata sy. Zëri i tij ishte i butë si mërmërimë. Kishte mirësi, të jepte vetëm dashuri, që buronte nga brendësia shpirtërore e tij, vetvetiu të bënte për vete." Ai ishte shumë i shkathët, me lëvizje të shpejta, e gjallëri. Harkanë të zezë dhe brucë me flokë tip gruel e lehtë. Taxhin e bardhë, teslim të varur në qafë me gurë qelibari, ishte simbol i dervishit bektashian.

Përvoja e jetës dhe bashkëpunimi me klerikët e njohur të kohës, e bënë atë një figurë të nderuar e të respektuar. Miku dhe shoku më i ngushtë i tij ishte baba Shaban Prishta nga fshati Buz i Tepelenës si edhe dervish Medin Gllava. Fizionomia e këtij dervishi ishte ajo, e një kalenteri, shëtitës, humanitar, bamirës, propagadues i



tarikatis bektashian. Ai gjithmonë eci në udhën bektashiane, në udhën mistike islame; ecja e tij ishte pjesë e vet karakterit të tij, i heshtur në pamje, i mendueshëm, por shumë i qartë dhe i kthjellët në mendime dhe veprime. Fjalën e kthente në vepër; në ecje e sipër, e gjeje në Vërzhezhë herë pas here, por udhëtimi nuk ndalej aty, e gjeje në: Dobrushë, Radësh, Koritë, Mollas, Strorë, Selan, Novaj, Baragullas, Nishovë, Kapinovë, Lubesh, Dardhë, (Nahijen e Beratit kishte bazën e tij kryesore) Tomoricë, në Dobrenj, Çërricë, Kuç e Barç, Grëmsh, në gjithë Skraparin. Gjithësesi, bënte udhëtime të gjata, fshat më fshat, kalonte me kalë gjithë jugun e Shqipërisë e gjeje: Berat, Korçë dhe Kolonjë, Leskovik dhe Përmet, Tepelenë dhe Vlorë. Kurse jashtë vendit shkoi në Klubin e Manastirit, Janinës, në Rumani, në të famshmen teqe në Dimotekë. Ai vajti në Haxhi Bektash dhe në pelegrinazhet e vendeve të Lindjes, Qerbela, Nexhef të Irakut. Ai ishte i kudondodhur. Me veprimtarinë intensive, të përditshme, të gjithanshme, shumë shpejt u kthye në një "inxhinier", ndërtonjës i urave, rrugëve, puseve, çesmave me kupa guri (gurra uji). Përgatiste "kamina gëlqere" (furra të djegies së gurëve gëlqerorë, lënda e parë e ndërtimit), me përvojën e ustallarëve të vjetër, u bë profesionist në ndërtim, për të ndihmuar popullin e tij, në vitet 1907-1919. Gjithmonë i paepur, i palëkundur, në dashurinë e pakufishme në Zot. I mësonte fëmijët, të rinjtë dhe të rejtat, të rriturit me këtë dashuri, buzëqeshja e tij, ishte e ëmbël, buzëqeshje e natyrshme, se e donte njeriun,

për besimtarin mendonte në çdo çast, e ndihmonte të vobektin, i dëgjonte me vemendje sejcilin me qetësi, dhe i ndihmonte me mënyrën e tij, në këshilla dhe urata. Kur ishte nevoja edhe me ndihmë materiale. Dervishi shëtitës ishte mësues dhe nxënës, mësimin nuk e ndante nga punët e përditshme, për arësimin kombëtar me patriotët e tjerë skraparas bëri gjithçka. Ishte i pranishëm me baba Xhaferin, baba Shabanin e teqesë së Prishtës, vëllai, shoku i tij më i ngushtë. Edhe pse jeta e tij qe shumë e shkurtër, ai bëri punë të mëdha, jetoj shpirtërisht, me bindje të plotë, tek Zoti. Ai jeton edhe sot, nuk i humbet fama, vepra, gjurmët që la kudo në Shqipëri, në veprimtari patriotike dhe atdhetare, ndërtonjës i rrallë në rrugë, ura, puse dhe çezma. Në Tomor, i shërbeu malit plotë pelegrinë, themelonjës i teqesë së Kulmakut, teqesë së Tomorit. Populli e quajti dervishi shpirtmirë i teqesë së Kulmakut. Mbeti organizatori më i mirë i pelegrinazhit masiv, në Tomor, Abaz Ali, në traditën shekullore, e gjallëroi pelegrinazhin më të vjetër në Europë, në Tomorin mitik, "Baba Tomor". Nuk ka në botë mal, me emrin, "Mal Baba".

Dervishi përjetësoi përgjithmonë besimin e malit mitik të lashtë, dhe i dha traditën, vazhdimësinë në përjetësi, në udhën mistike bektashiane. Ai ka qënë dhe do të mbetet krenari për çdo brez bektashian, sepse falte vetëm dashuri.



LET US ASSUME MORE IM

The World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, participates at the International Conference "Diversity in unity and the fundamental liberties for the Christians and Moslems in the Middle East", organized in Beirut.



The Lebanese Parliament and the Orthodox Interparliamentary Assembly, in collaboration with the Interparliamentary Arab Union, organized in Beirut, in the halls of the Parliament, the International Conference "Diversity in unity and the fundamental liberties for the Christians and the Moslems in the Middle East", in the dates 3-4 April 2018.

The World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, was invited to this event and he was respect-

fully received by the the highest representatives of the Lebanese Parliament and of the International Secretariate of the Orthodox Assembly.

In the opening ceremony of the Conference, the participants were very interested on the speech of the President of the Lebanese Parliament, Mr.Nahib Berri. Talking about the sorrowful realities of the Middle East, he underlined the importance of a long-term concrete collaboration, at the highest levels of representation of the Christians and Moslems in the Middle East,


which could lead to a lasting peace.

Further, the visit to the mosaics of Athos Mountain, knowing their spiritual miracles, made more attractive this event. After, religious leaders and members of the Lebanese Parliament, brought to the participants of the event their experiences, as well as their ideas how could be faced the situations we live.

The World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Baba Edmond Brahimaj, in His speech, sad, among others: "It is a special honor and pleasure for me, to participate at this Conference and to transmit to you the best wishes of the World Bektashi Community, for you and your families! Let the High God reward our devotion to our long voyage to the universal peace! Of course, the topic we are discussing today, on the diversity in unity and on the fundamental liberties for the Christians and the Moslems in the Middle East, is particularly important one in the context of the burning background of the wars of religious, racial or ethnic character. My personal perception is that these "burning hearths", more than the superficial inter-religious conflicts, are caused by economical and geostrategical fac-

PORTANT RESPONSIBILITIES

tors, by different forces and interests, by the eternal and incorrigible cupidity for terrestrial riches. By this point of view, I would say that our contribution as religious leaders is a very important one and we have to assume more responsibilities, as a representative institution, in order to extinguish the flames and to work for long lasting peace. We completely agree the idea that the parliament, as the representative institution of the citizens and the place where are formulated their religious and political requests, has the main role for the preservation and the enrichment of the spiritual traditions and identities of the peoples. Meanwhile, we can not say that the connecting bridges between the parliaments and the aspirations of the peoples that they represent are built on solid foundations and intangible by the dangers, internal or external ones. By this point of view, I think that this Conference, through our discussions, could be able to undertake concrete initiatives, especially on the long lasting installation of the belief to the Creator and on its connection with the civil society. Until



some decades ago, the Middle East demonstrated a normal coexistence in the spiritual aspect, where all the religions and faiths, alimanted by the devotion of the believers, could travel for long time, during the centuries. The trends to call "brother" the people who the High God brought near you, people of different race or color, consist just in the religious coexistence, a concept which is a will of God, strongly respected by the human nature. This has been one of the reasons because of which the Middle East, with its nations and civilizations, brought to the World examples of great moral and spiritual values".





URTËSIA

REVISTË FETARE-SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.125 PRILL 2018